



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 02-052-01-4974-25

Nr. i fq. / Br.str. / No.pg. 21.02.2025



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq



Zyra e Kryetarit
Kabinet Predcednika/ Office of the Mayor

Datë/Data/Date:	19/02/ 2025
Nga/Od/From:	Kryetari i Komunës z.Xhafer Gashi
Për/Za/To:	-Kryesuesen e Kuvendit Vlora Mjekiqi –Kabashi -Anëtarët e Kuvendit Komunal
Tema/Subjekat/Subject	Raporti i Punës Janar –Dhjetor 2024

Përshëndetje e nderuara Kryesuese e Kuvendit Komunal,
Të nderuar anëtar të Kuvendit Komunal

Ju lutem që në mbledhjen e Kuvendit Komunal në muajin Shkurt ta shqyrtoni :

**RAPORTIN E PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE EKZEKUTIVI KOMUNAL PËR
PERIUDHËN Janar –Dhjetor 2024**

Ky plan është ndarë në dy pjesë :

-Raporti i ekzekutivit

-Raporti i zyrës së prokurimit .

Ju faleminderit për bashkëpunim !



KOMUNA OBILIQ

OPSTINA OBILIQ

MUNICIPALITY OBILIQ

***RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE
EKZEKUTIVIT KOMUNAL 2024***

Janar –Dhjetor 2024

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË KOMUNËS

XHAFER GASHI

.....

Qytetarë të Obiliqit ,

Anëtar të Kuvendit ,

Si rezultat të punës dymbëdhjetë mujore të angazhimit maksimal në shërbim të qytetit dhe fshatrave , ju paraqes raportin vjetor për vitin 2024 para jush dhe Kuvendit Komunal .

Raport ky i projekteve dhe të arriturave dhe sfidave të cilat na presin së bashku ! Raport ky që së bashku hartuam buxhet , mbikëqyrëm së bashku dhe së bashku ju gëzuam investime

Ky raport pasqyron angazhimet tona të përbashkëta për aktivitetet , arritjet, sfidat dhe planet për të ardhmen e qytetit tonë.

Raporti vjetor i punë sonë është mjet i rëndësishëm për transparencën tonë të plotë dhe llogaridhënien para jush .

Risi për vitin 2024 ishte edhe forma e re e hartimit të buxhetit ‘ ‘ Buxheti me pjesëmarrje ‘ ‘ , formë kjo që u realizua në pesë lokalitetet .

Viti që lamë pas ishte vit i vështirë për të gjithë ne , por së bashku me ju kemi arritur që të përmbushim obligimet karshi jush , duke qene së bashku kemi arritura të kalojmë të gjitha sfidat së bashku .

Ne me vendimet e marra jemi munduar që sa do pak të zbusim këtë krizë, që nga lindja, shkollimit , udhëtimi , transporti , subvencionet deri tek shërbimet mortore .

Viti 2024 ishte vit i sfidave dhe suksese tona të përbashkëta .

Ne raportimet tona me ju ne dy here brenda viti ju kemi informuar për punën dhe sfidat e përbashkëta

Viti 2024 ishte jashtë zakonishë sifidues për fakti që përmes procedurave përmbartimore sektori i arsimit ka arrit që kontratën kolektive ta realizon për mes procedurave gjyqësore. Barrën financiare e kanë bartë komuna e jo Ministria e Arsmit .

Përkunder shkresave dhe ankesave që kjo barrë e rëndë finacire po shkakton problem ne buxhetet komunale e ne veçanti komunës sonë , nuk kemi hasur në mirëkuptim nga Qeveria e Republikës së Kosovës .

Për kundër sidave të mëdha që kishim , ne si komunë kemi arritur që shpenzimi dhe planifikimi të jetë jashtëzakonisht i mirë .

*Këto të arritura janë fal jush me kontributin e dhënë në dëgjimet buxhetor e takimet tjera , ku ju keni kryet obligimet qytetare duke bërë që buxheti ynë i planifikuar të realizohet në masën prej **90.42%** edhe pse kemi marr vendim në Kuvend Komunal për lirim të gjithë taksapaguesi e Obiliqit në shumën deri në 100 €. (vendimi i 2023 por që ka pas efekt në ato raste kur qytetarët kanë pagurë është liruar për vitin 2024)*

*Dhe shpenzimi i buxhetit për investime kapitale për vitin 2024 në masen prej **100%***

Kjo është puna e pa lodhshme e zyrtarëve komunal dhe ekipit mbështetës .

Trasfomimi i qyteti në zonë urban moderne .

Ka filliar projekti më madhore deri me tani dhe po vazhdon ‘ Koogjenerimi –Shtrirja e rrjetit të Sistemi të ngrohjes qendrore në Obiliq ‘

Pas mirartimit të Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqi është miratuar edhe Hartat Zonale Komunale . Vegova këto aktivitet më madhore duke mos lënë anash edhe tjerat.

Kemi vazdhuar me investimet kapitale ne infrastrukturë, arsim, shëndetësi , kuluturë , rini sport etje .

Qyteti i Kulturës – ishte vit i aktivcitate të mëdha kulturore për qytetin dhe qytetarët .

Bashkëpunimi me Institucionet Qendrore , donatorët , e organizata tjera i vazhdueshëm .

Parteritet me USIAD , OSBE , DEMOS , Ambasadat ,Bankën Botërore ,BE-në .

Të nderuar anëtar të Kuvendit Komunal së bashku me ju kemi arritur që planin vjetore të punës ta realizojmë dhe buxhetin e planifikuar ta menagjojmë ne mënyrën me të mrë të mundëshem .Po ashtu ju kemi raportuar ne baza tre mujore për gjendje financiare dhe raportin vjetor .

Më poshtë do të gjeni raportet vjetore të Drejtorive dhe sektorëve përkatës komunal .

Përmbledhje

Fjala e Kryetarit	2
DREJRORI E ADMINISTRATËS	4
DKRS –	8
DREJTORIA E ARSIMIT -	18
DSHMS -	41
Drejtoria e Inspektionit	67
DSHPE –	69
DMM –	75
DBZHR -	79
Drejtoria e Infrastrukturës Lokale –	80
DEFZH –	88
DPUPK –	97
Njësia e Burimeve Njerëzore –	124
Njësiti Antidiskriminim dhe Barazi Gjinore	130
Zyra ligjore -	126

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Drejtoria e Administratës në kuadër të kompetencave të saj dhe në përputhshmëri me legjislacionin dhe aktet normative në fuqi, ka kryer punët administrative jo vetëm në shërbim administrative për qytetarët e komunës së Obiliqit.

Duke pasur parasysh të gjitha përgjegjësit, Drejtoria e Administratës gjatë vitit të lamë pas në mënyrë profesionale është kujdesur që të jenë sa më pranë qytetarëve të Komunës së Obiliqit., duke tentuar të gjejë zgjidhje për çdo çështje të adresuar pranë kësaj Drejtorie.

Duke qenë se në vazhdimësi po tentojmë të përmisojmë shërbimet tona, në hyrje të objektit të komunës, kemi vendosur kutinë e ankesave dhe kutinë e lëvdatave, ku në këtë mënyrë qytetarët kanë mundësi të na ndihmojnë që të kryejmë një punë profesionale. Përkushtimi ynë që shërbimet administrative për qytetarët të jenë sa më të shpejta, drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka funksionalizuar E-kioskun në Komunën e Obiliqit të cilat shërbime ofrohen çdo ditë çdo 24 orë. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, ka thelluar përkushtimin për t'ju sjellë eksperiencën më të lehtë dhe efikase të mundshme në marrjen e shërbimeve komunale. Për këtë qëllim, kemi funksionalizuar platformën tonë të re të aplikimeve online, tani ju keni mundësinë të aplikoni për shërbimet tona nga komoditeti i shtëpisë tuaj, pa pasur nevojë të vizitoni zyrat tona ose të pritni në radhë.

Në këtë raport vjetor, jemi munduar të përfshijmë të gjitha detyrat e Drejtorisë së Administratës gjatë vitit 2024, të ndara nëpër sektorët përkatës.

SEKTORI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Sektori i Administratës kryen të gjitha punën profesionale, juridike të Kuvendit dhe Komuniteteve obligative dhe mbikëqyrë punët në QSHQ (Qendra e Shërbimit për Qytetarë).

Ky sektor përgatit të gjitha vendimet sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës, prokurimit dhe njësisë kërkuese, si dhe kthen përgjigje në të gjitha kërkesat e qytetarëve të drejtuar Kryetarit dhe bordit të drejtorëve.

Në kuadër të këtij sektori janë Kuvendi, Qendra për Shërbim me Qytetar, Arkiva, Logjistika dhe Teknologjia Informativë.

KUVENDI KOMUNAL

Gjatë kësaj periudhe Janar-dhjetor/2024, 12 mbledhje të rregullta, 3 mbledhje të jashtëzakonshme dhe 2 mbledhje solemne.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 12 mbledhje.

Komiteti për komunitete ka mbajtur 12 mbledhje.

Komiteti Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur 5 mbledhje.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi Komunal ka miratuar 55 vendime, si dhe keto rregullore:.

1. Aprovohet Rregullorja (KO) nr.01/2024 për organizimin e punës në shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, udhëheqësit, mësime dhënësit, nëpunësit profesional, mbështetës, nxënësit dhe masat disiplinore, nr.01-060-01-6552-24, e dt.04.03.2024.
2. Aprovohet Rregullorja (KO) nr.02/2024 nr.01-060S-01-9738-24, e dt,04.04.2024 kapitulli V neni 12 Për plotësim Ndryshim të Rregullores nr.05/2022, Për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoha Komunale në Komunën e Obiliqit.
3. Aprovohet Rregullorja (KO) nr.03/2024, nr.01-060-01-12355-24e dt.02.05.2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores (KO) nr.02 /2023 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Obiliqit.
4. Miratimi i Projekt – “Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024 – 2032.
5. Strategjia e Komunikimit dhe Qasja 2024 – 2026 nr. 01-060-01-36680-24, e dt.29.11.2024.
6. Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare nr.02-060-01-36666-24, i dt.29.11.2024.
7. Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit 2025 -2029 nr.01-060-01-36654-24-24, i dt.29.11.2024.
8. Statuti i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Obiliq 2024, nr.01-060-01-21563-24, i dt.31.07.2024.

Gjithashtu në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme bëhet edhe përkthimi shqip-serbisht dhe anasjelltas i të gjitha materialeve për KK-se , komiteteve obligative , rregulloreve, vendimeve, konkurseve, Plane vepruese, Konkurse, Kontrata pune, Përgjigje për punëtorët dhe palët në konkurs, Procesverbale, ekstrakte të KK-se, K. për komunitete, Raporte të drejtorive, Përkthimi simulant i të gjitha mbledhjeve sipas orarit mujor, komisioneve të ndryshme, Korniza afatmesme buxhetore, Buxheti komunal 2024, dhe materialeve tjera sipas kërkesës së drejtorive.

QENDRA E SHËRBIMEVE PËR QYTETARËT DHE ARKIVA

Sa i përket QSHQ(Qendra e shërbimit për qytetarë) dhe arkiv-ës, janë kryer punët e përditshme në pranim-dorëzimin e kërkesave të qytetarëve, dhënia e informacioneve qytetarëve, ndihma dhe këshilla e nevojshme për realizimin e kërkesave dhe ankesave të tyre si dhe protokollimi i lendeve të brendshme.

Dorëzimi i lendeve për palët dhe institucionet e jashtme-386, ndërsa nga posta e jashtme janë evidentuar 1.568 lende.

Këto punë (lëndë) kryhen përmes intranetit dhe librave përkatëse, ku për periudhën raportuese paraqesim statistikat sipas programit, si më poshtë:

Përshkrimi	lëndë
Te pranuar	4
Ne proces	1,913
Te miratuara	15,156
Te refuzuara	1,103

të hedhura poshtë	23
të pezulluara	8
të ceduara	41
të anuluar	52
të përfunduara	21,357
Gjithsejtë	39,657

Sa i përket sistemit Intranet, afati dhe shqyrtimi kërkesave është 30 ditë, mirëpo meqenëse drejtorinë përkatëse në Komunën e Obiliqit, çdo vit ndajnë subvencione të natyrave të ndryshme, është e pamundur që të gjitha kërkesat të shqyrtohen brenda afatit të sistemit.

LOGJISTIKA

Nga zyrtarja e logjistikës në Drejtorinë e Administratës, janë realizuar Hyrje-Dalje nga depoja për administratën komunale, institucionet arsimore si dhe institucionet shëndetësore. Po ashtu janë realizuar kërkesat për material administrativ hyrje-dalje në sistemin E-pasurisë gjithashtu edhe hyrjet në thesar, si dhe për të gjitha lëndët e prokurimit .

SEKTORI I GJENDJES CIVILE

Në zyrën e Gjendjes Civile gjatë periudhës janar-shtator/2024 janë kryer të gjitha detyrat sipas përgjegjësive të nëpunësve civil dhe ligjeve në ku fuqi, ku gjithsej janë dorëzuar:

Në këtë zyre gjatë muajit janar –dhjetor 2024, janë lëshuar:

Pershkrimi	Totali
Certifikata e lindjes	4,404
Certifikata e Martesës	2,418
Vërtetim nga arkiva	70
Certifikata e statusit martesor	453
Certifikata e Shtetësisë	206
Ekstrakti i lindjes	14,260
Deklarate e bashkesise familjare	1,838
Certifikata e vdekjes	717
Certifikata e vendbanimit	497
TOTALI	24,863

Zyrtari i IT-se

- Janë ber 150 formatizime dhe instalime për kompjuterët e ri dhe janë ber intervenime tek institucionet komunale, shëndetësi, arsim si dhe shkollat e komunës si dhe janë ber

shumë punë tjera duke përfshirë krijimin në SIMBNJ, 45 kyçje ne sistem dhe 385 qasje në HRMI .

- Nga lëmi e servisimit të pajisjeve të IT janë servisuar shumë pajisje duke pasur problem me rrym dhe kanë shkaktuar dëme në pajisje të IT-së janë djegur 22 Power suplai (pajisje të furnizimit me rrym)
- Ingjizimet e mbledhjeve të kuvendit si dhe transmetimi drejt përderej me teleprezenc në MAPL, KPF-se dhe K.Komunitete dhe eshte ber kyçjan ne CMS,
- Në web faqe postimi i Rregulloreve të cilat nuk kanë qen të postuara në CMS dhe dizajni i ballinës dhe shumë ndryshime ne CMS (Contect menagmet System) dhe CSS .dhe konfigurimi, dizajni i ri dhe shtimin e raporteve në secilën drejtori ,
- Lëshimin në punë të sistemit të ri të intranetet në QPS menaxhimin e sistemit të shumta në Qendrën për punë Sociale

Aplikacionet komunale në të cilën behet Administrimi i tyre .

- 1.Intranet
 - 2.E-arkiva
 - 3.E-pasuria
 - 4.Simbnj
 - 5.SMVP
 - 6.Domenin Mun.Gov.irk.rks
 - 7.CMS
 - 8.Free Balancë Web Aplikacion
 - 9.Sistemin e MPB për riatdhesim
 - 10.Softwerin për Përkthim donacion nga USAIDI
 - 11.Menagjimin e të dhënave personale i caktuar nga ASHMDHP (MPB) gjithsej 12 raste
 - 12 Menaxhimin e softuerit për Hapjen dhe caktimin e orarit te dyerve për hyrje dhe dalje
 - 13 HRMIS SYSTEM
 - 14 HRIS sistemin e menaxhimit të fermerëve , Subvencionimin ,LPIS
 - 15 Sistemin në Kadastër KCID, KCLIS,
 - 16 Kuik Box sistemin e menaxhimit të financave,
- Ndërsa ne QKMF menaxhimin e SISH Aplikacionit
- Ne Arsim kemi E-Shkollën i cili eshë duke u ber analiza për fillimin dhe implementimin nga MASHT ,ne kemi qen ne fazën e testimeve kemi qen ne shkollat ku eshë ber testi dhe eshë ber qe te shikohet dhe a mundemi te shikojmë a mundemi te fillojmë implementimin e tyre ,
- Mbrojtja e te Dhënave Personale dhe Konsultimi me Agjencinë per Mbrojtjen e te dhënave Personale për qasje ne te dhëna te kërkuara nga Organizatat dhe shoqëria civile gjithsej jan 24 qasje dhe 18 vendime
- 180 kërkesa për regjistrim në e-pasuri në projektet kapitale apo mbi 1,000.00 € dhe korrigjimin e regjistrimit nga vijim ne projekte kapitale

Të gjitha të dhënat më lartë, janë të bazuara në raportet e sektorëve përkatës të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, në përputhje me detyrat zyrtare të nëpunësve civil brenda Drejtorisë.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Obiliqit, gjatë gjashtëmujorit të parë punës, ka përfunduar aktivitetet të planifikuara në kuadër të Planit vjetori të Punës për vitin 2023, bazuar në kompetencat, objektivat dhe synimet e përgjithshme të drejtorisë duke udhëhequr me resurset (burimet) lokale kulturore, sportive e rinore të Komunës së Obiliqit.

Në këtë raport gjashtëmujor (janar-qershor) të punës janë të përfshira aktivitetet dhe projektet e zhvilluara në drejtori, në fushën e kulturës, sportit dhe rinisë.

Personeli i DKRS-së, ka bërë përpjekje maksimale në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke përbushur planin e punës, qëllimet dhe objektivat për vitin 2024 dhe ka rezultuar me sukses në aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe.

Aktivitetet e DKRS-së për periudhën

✓ *Përgatitja dhe hartimi i Planit të Punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2024*

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport duke u bazuar në synimet dhe objektivat e përgjithshme, ka hartuar një Plan të pasuruar të Punës për vitin 2024, duke planifikuar një sërë aktivitetesh kulturore, artistike, sportive e rinore, të cilat do realizohen në bashkëpunim me OJQ-të e komunës së Obiliqit. Personeli i DKRS-së, do të bëjë përpjekje maksimale në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke përbushur planin e punës, qëllimet dhe objektivat për vitin 2024.

✓ *Formimi i Këshillit Organizativ për organizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara sipas Planit të Punës së DKRS-së për vitin 2024*

Me vendim të Kryetarit të Komunës, është formuar Këshilli Organizativ për organizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara sipas Planit të Punës së DKRS-së për vitin 2024, me qëllim të bashkërendimit, koordinimit të mirëfilltë në realizimin sa më të suksesshëm të aktiviteteve.

✓ *Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara nga DKRS-ja nga viti paraprak*

Zyrtarët e DKRS-së, kanë pranuar raportet financiare dhe narrative të ojq-ve kulturore, sportive e rinore që kanë qënë përfituese nga thirrjet publike për subvencionim gjatë vitit 2023.

- ✓ ***Përgaditja e planit të prokurimit dhe planit të shpenzimit për projektet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.***
- ✓ ***Mbikëqyrja profesionale dhe teknike për fillimin e sezonit për të gjitha klubet sportive:***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, është përkujdesur për realizimin e të gjitha përgaditjeve në Palestrën Sportive “Adem Jashari” që për klubet sportive të krijohen kushtet sa më të përshtatshme për realizimin e stervitjeve, ndeshjeve miqësore e kampionale.

- ✓ ***Orari vjetor për stërvitje të klubeve sportive:***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, është përkujdesur për përpilimin e orarit të stërvitjeve të klubeve sportive që realizohen në Palestrën Sportive “Adem Jashari”.

- ✓ ***Shpallja e Thirrjes Publike për subvencionim nga DKRS-ja për vitin 2024***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, në kuadër të kategorisë së subvencionimit, për vitin 2024 ka planifikuar vlerën prej 130 mijë euro, ku përmes kësaj thirrje publike iu ofrohet mbështetje financiare të gjitha organizatave jo-qeveritare kulturore, sportive, rinore si dhe individëve të regjistruar në Republikën e Kosovës, që veprojnë në komunën e Obiliqit, programi i të cilave është i fokusuar në ruajtjen e traditës kulturore, fuqizimin dhe avancimin e të rinjëve dhe sportit. Thirrja publike me **Nr.14-660/11-7682/24**, ka qenë e hapur për aplikim nga data 15 mars 2024 deri me datë 29 mars 2024.

- ✓ ***Organizimi i takimeve me OJQ-të, sportive, kulturore e rinore***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, si çdo fillim vit, ka organizuar takime me OJQ-të, klubet sportive e shoqatat kulturore që veprojnë në komunën e Obiliqit, në këto takime u njoftuan nga afër me Planin e Punës së drejtorisë për vitin 2024, për mundësit e bashkëpunimit në realizimin e objektivave të përbashkëta përgjatë vitit, me qëllim të rritjes së aktiviteteve por dhe nxitjes së pjesëmarrjes së të rinjëve në aktivitete kulturore, rinore dhe sportive.

- ✓ ***Shënimi i 16- vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës***

Për nder të 17 Shkurtit- Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është shënuar kjo ditë me një sërë aktivitete;

- Ceremonia e homazheve pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmoreve të Kombit në Sheshin e qytetit të Obiliqit.
 - Ceremonia e homazheve në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
 - Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, është organizuar kjo ditë feste me dy pjesë: ***Pjesa e parë:*** Manifestimi qendror kulturor-artistik, për nder të 17 Shkurtit, në bashkëpunim me Gjinnazin “17 Shkurti” dhe Ansamblin e Qytetit.
-

Pjesa e dytë: Koncerti festiv i Ansambilit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe Ansambilit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore të Shqipërisë.

✓ ***Shënimi i 8 Marsit- Ditës Ndërkombëtare të Gruas***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, është përkujdesur që përmes dhurimit të një lule trëndafil të gratë në administratën komunale, në stacionin policor në Obiliq, përfaqësueset nga KFOR-i LMT, mjekët dhe infermieret, mësueset, të shënoj Ditën Ndërkombëtare të Gruas, duke theksuar se themelet e një familje, shoqërie dhe institucioni janë gratë.

✓ ***Akademi përkujtimore në 25 vjetorin e rënies së Dëshmoreve të Familjes Rama***

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, është shënuar 25 vjetorit i rënies së Dëshmorëve të Familjes Rama, përmes Akademisë Përkujtimore, duke nderuar jetën dhe veprën dhënë për liri e shtetndërtim, nën prezencën e familjes Rama, familjeve të Dëshmorëve e Martirëve të lirisë, Shoqatave të Dalura nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, deputetë të Kuvendit të Kosovës, Komandantit të Stacionit Policor, asambleistë, ekzekutivi dhe bashkëqytetarë. Kjo Akademi u përcoll me një dokumentar dhënë për sakrificën e Dëshmorëve të Familjes Rama dhe pika artistike nga nxënës të SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova” dhe artistit Hysni Klinaku.

✓ ***Garat Komunale me shkollat***

Në kuadër të kalendarit të garave sportive, DKRS-ja në bashkëpunim me DKA-në dhe Shoqatën e Pedagoqeve ,kanë organizuar garat komunale në:

- Sportin e Basketbollit,
- Sportin e Hendbollit,
- Sportin e Volejbollit

✓ ***Akademi përkujtimore në 25 vjetorin e rënies së Dëshmorit të Kombit Ferid Curri***

Në 25 vjetorin e rënies së Dëshmorit të Kombit, Ferid Curri, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit dhe nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, me Akademi Përkujtimore kujtuam dhe nderuam jetën dhe veprën dhënë për liri e pavarësi, nën prezencën e familjes Curri, familjeve të Dëshmorëve e Martirëve të lirisë, Shoqatave të Dalura nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bashkëveprimtarët e bashkëlufetarët e Dëshmorit, deputetë të Kuvendit të Kosovës, Kryetarin e KBI-së në Obiliq, Kryesusen e KK Obiliq, asambleistë, ekzekutivin dhe bashkëqytetarët. Akademia u përcoll me këngë të kënduara për heroizmin e Dëshmorit Ferid Curri, nga Daim Zeqiri dhe nipat e Sefë Mleqanit ku dhe promovuan videoklipin e këngës "Zjarrët e lirisë" kushtuar Dëshmorit Ferid Curri.

✓ ***Kampionati shtetëror i Karates U-17***

Në Palestrën Sportive "Adem Jashari", u mbajt Kampionati shtetëror i Karatesë për grupmoshat 7-U14, organizuar nga Federata e Karatesë së Kosovës, me pjesëmarrjen e 49 ekipeve nga të gjitha komunat e Kosovës e nikoqir i këtij organizimi ishte Komuna e Obiliqit përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

✓ ***Shënimi i 5 Majit- Ditës së Dëshmorëve të Kombit***

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi dhe nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport përmes një Akademie Përkujtimore është shënuar 5 Maji- Dita e Dëshmorëve të Kombit. Në Akademi janë ndarë mirënjohje për familjet e Dëshmoreve dhe Martirve të Lirisë si dhe u përcoll më një recitim skenik nga Teatri i Qytetit dhe me përgaditje artistike nga Ansambli i Qytetit.

✓ ***Shënimi i Javës Aerounatike të Kosovës- "Kastriot Open 2024"***

Në bashkëpunim me Klubin e paragllajding-ut "Shqiponjat e Kastriotit", në Obiliq, është shënuar Java Aerounatike e Kosovës "Kastriot Open 2024" e cila ka filluar nga data 26 Maj 2024 deri me datë 02 Qershor 2024, një javë të mbushur me përplot aktivitete kreative që ndërliken me këtë sport si dhe nën pjesëmarrjen e tetë (8) shteteve të botës dhe nën pjesëmarrjen e katërdhjetë e shtatë (47) pilot të talentuar.

✓ ***Shënimi i 1 Qershorit- Ditës Ndërkombëtare të Fëmijeve***

Për nder të 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijeve, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, është përkujdesur të realizoj aktivitete në bashkëpunim me OJQ-të dhe akteret institucional te artit, kështu:

- ***Aktiviteti me Maskota për fëmijët:*** në bashkëpunim me Qendrën Rinore, është realizuar festivali me maskota për fëmijët, në amfiteatrin e sheshit të qytetit të Obiliqit.
- ***Shfaqja premiere "PITER PAN":*** në bashkëpunim me Baletin Kombëtar të Kosovës, në Shtëpinë e Kulturës "Xhavit Haziri" në Obiliq, u dha shfaqja premier "PITER PAN" e Baletit Kombëtar të Kosovës.

✓ ***Shënimi i 14 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Komunës së Obiliqit***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, z.Xhafer Gashi, ka shënuar aktivitete të shumta kulturore dhe sportive në shënimin e 14 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Komunës së Obiliqit, duke organizuar aktivitetet si në vijim:

- ***Shënimi i 11 Qershorit – Krisma e parë e Lirisë në fshatin Hamidi,*** 11 qershor 1998 shënon Krismën e parë të lirisë në trevat tona, tani e 26 vite pas, nderuam heronjtë e trimat të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke nisur kështu Javën e Çlirimit në Komunën e Obiliqit. Aktiviteti u shënuar nën pjesëmarrjen e drejtorëve të ekzekutivit, drejtoreshës së Gjimnazit dhe një grupi nxënësve (gjeneratë e Pavarësisë), të cilët patën

rastin që përmes një kronologji të ngjarjeve dhënë nga Profesori i Historisë, z. Gazmend Mirena, të njohin përpjekjet shekullore, ngjarjet e ditës 11 qershor 1998 e deri tek kurorëzimi i çlirimit të vendit.

- **Promovimi i librit “Stina e Luleve”**, në shënimin e Javës së Çlirimit, u promovua libri "Stina e Luleve", përmbledhje poezish nga grup nxënësish dhe përgaditur për botim nga Profesoresha njëherit dhe autore znj. Sanije Ahmeti Dubova, duke shënuar kështu Ditën e Poezisë në Obiliq.
- **Premiera e shfaqjes "Lufta e Gruas" nga Teatri i Qytetit**, në kuadër të aktiviteteve për Javën e Çlirimit në Komunën e Obiliqit, u dha premiera e shfaqjes "Lufta e Gruas" nga Teatri i Qytetit.
- **Ceremonia e homazheve pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmoreve të Kombit**, në Sheshin e qytetit.
- **Manifestimi Qendror për nder të Ditës së Çlirimit**, Dita e Çlirimit u përmyll me Manifestimin Qendror në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri”, nën prezencën e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, Kryesueses së Kuvendit Komunal, anëtarët e kuvendit komunal, ekzekutivit, përfaqësuesve të SHDL-së, familjarëve të dëshmorëve dhe martirëve, përfaqësuesve të KBI-së, qytetarëve dhe përfaqësuesve të institucioneve lokale. Manifestimi u përmyll me poezi nga Teatri i Qytetit, me këngën “Ai është i Gjallë” nga artistja e re Alena Xhota, këngë patriotike nga artisti Vesad Mjeku, si dhe me pika artistike nga Ansambli i Këngëve dhe Valleve “AKV Qyteti i Obiliqit”.
- **Turniri tradicional i Boksit**, në amfiteatrin e Sheshit të Qytetit, është mbajtur turniri tradicional i Boksit, në bashkëpunim me Klubin e Boksit “Kastrioti- Obiliq” dhe Federatën e Boksit të Kosovës, nën pjesëmarrjen e 28 boksierëve.

Aktiviteti në objektet nën administrimin e DKRS-së:

✓ **Shtëpia e Kulturës “Xhavit Haziri”**

Në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri” janë realizuar aktivitete kulturor-artistike, njëkohësisht janë mbajtur ushtrimet e rregullta nga AKV “Qyteti i Obiliqit” dhe ushtrimet skenike e teatrale të Teatrit të Qytetit, aktivitete të tjera nga OJQ-të e Komunës së Obiliqit, shfaqje të baletit nga shkollat e baletit “Pirouette”, “Let’s Dance”.

✓ Palestra Sportive “Adem Jashari”

Në Palestrën Sportive “Adem Jashari”, janë realizuar stërvitjet e rregullta të klubeve, ndeshjet miqësore dhe aktivitete të tjera sportive, nuk ka pasur asnjë ndërprerje të aktiviteteve gjatë kësaj periudhe.

✓ Biblioteka e Qytetit

Në Bibliotekë e Qytetit ka vijuar puna e rregullt, njëkohësisht, kemi bashkëpunuar me dashamirës të librit: mësimdhënës, nxënës, shkrimtar , në mënyrë që të kemi ngritje të vetëdijes rreth lexushmërisë.

Në nderim të të rënëve për liri e shtet ndërtim, Drejtoria për Kulturë ka organizuar:

- Ceremoni të homazheve për nder të Epopesë së UÇK-së, 5-6 dhe 7 Mars, pranë “Pllakës Përkujtimore të Dëshmorëve” në Sheshin e qytetit dhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmoreve të familjes Rama, Martirëve të familjes Halimi dhe Haliti”.
- Ceremoni të homazheve në nderim të të rënëve të familjes Morina, pranë Pllakës përkujtimore në Milloshevë.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Ferit Curri”, pranë lapidarit në fshatin Mazgit.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Fejzullah Grajçevci”, pranë Pllakës Përkujtimore në fshatin Graboc.
- Ceremonia e homazheve në nderim të Dëshmorëve të Kombit- Shënimi i 5 Majit “Dita e Dëshmorëve të Kombit” , pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmorëve në Sheshin e Qytetit “Dëshmoret e Kombit”.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Murat Krasniqi”, në Stanoc.
- Ceremoni të homazheve pranë “Pllakës Përkujtimore të Dëshmorëve”, në fshatin Siboc.
- Ceremoni të homazheve pranë në nderim të “Dëshmorit Hasan Hasani”, pranë varrit në fshatin Mazgit.
- Ceremoni të homazheve te “Martirët e familjes Aliu”, pranë Pllakës Përkujtimore në fshatin Milloshevë.
- Ceremoni të homazheve për “Dëshmoret e rënë në Betejën e Hades”.

Shënim: Gjatë këtij gjashtëmujori (6) të punës, janë ndërmarrë veprime të tjera të cilat nuk janë të listuara në raport, janë diskutuar dhe komentuar aktivitete dhe ide të ndryshme që i përkasin sektorit të tashëgimisë, janë realizuar raporte të shumta përmbledhese për infrastrukturën fizike sportive, kulturore dhe rinore sipas kërkeses së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, janë realizuar takime me akteret të shumtë duke përfshirë takime me zyrtar nga MKRS-ja si dhe me përfaqësuesit e KFOR-it LMT K9 zviceran.

RAPORT PUNE MBI VEPRIMTARITË E TRI SEKTOREVE NË DKRS PËR PERIUdhËN KORRIK- SHTATOR -2024

I. SEKTORI I KULTURËS

- Shënimi i përvjetorit të 40-të të veprimtarisë muzikore të këngëtares, Hajrije Preniqi Gashi, e cila pas një karriere të suksesshme në Kosovë e mërgatë, këtë përvjetor të rëndësishëm, e shënoi në Shtëpinë e Kulturës **“Xhavit Haziri”** në kuadër të manifestimit të përvitshëm; **“Ditët e Diasporës”-2024**
 - Po në kuadër të këtij manifestimi, në sheshin e qytetit tonë **“ Dëshmorët e Kombit”** u organizua koncerti artistik me këngëtarë të njohur nga estrada jonë.
 - Instituti Albanologjik ka bërë një dhurim të vlefshëm për Bibliotekën e Qytetit, duke ofruar 90 tituj të botuar nga vetë Instituti. Ky kontribut pasuron fondin e bibliotekës dhe ndihmon në promovimin e studimeve albanologjike për lexuesit e qytetit.
 - Në sallën e Kuvendit Komunal, u mbajt Konferenca Shkencore Ndërkombëtare: **“Lufta e Dytë e Kosovës-1448”**. Kjo konferencë u organizua nga Komuna e Obiliqit, Instituti Albanologjik-Prishtinë, Instituti i Historisë **“Ali Hadri”-Prishtinë** dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup. Në kuadër të kësaj konferenceje, u prezantuan shumë kumtesa që kishin të bënin me këtë ngjarje historike.
 - Për të përputhur veprimtarinë e Ansambllit të Këngëve dhe Valleve-Obiliq me Ligjin e ri për Art dhe Kulturë, është bërë plotësim-ndryshimi i Statutit të këtij institucioni kulturor.
-

- Në bashkëpunim me UNDP-në janë mbajtur takime pune për realizimin e projektit të iniciuar nga UNDP-ja “ **Industritë Kreative**” i cili si i tillë ka për qëllim: Hartëzimin e Institucioneve Kulturore në Komunën e Obiliqit.
- Në përputhje me traditën e përkujtimit, si rëndomtë, janë mbajtur homazhe përkujtimore për dëshmorët dhe martirët e lirisë të Komunës së Obiliqit, duke respektuar rendin dhe ceremonitë e përcaktuara për nderimin e të rënëve.

II. SEKTORI I RINISË DHE SPORTIT

- Me rastin e shënimit të Javës Rinore 17-25 shtator, në kuadër të sektorit të rinisë u mbajtën një varg aktivitete kulturore, edukative dhe sportive, të dedikuara për të rinj dhe jo vetëm. Ishte një javë e mbushur me plot aktivitete të ndryshme, që përfshinin edukimin, kulturën, sportin dhe argëtimin.
 - ❖ **Aktivitete të shënuara me rastin e Javës Rinore**
 - Aktivitet me bicikleta : “*Një pedale më shumë, një hap më afër shëndetit*”
 🚦 **Vendi: Brezi i Gjellbër**
 - Debat në shesh-“ *Të rinjtë në vendimarrje*”
 🚦 **Vendi: Sheshi i Qytetit “Dëshmorët e Kombit”**
 - Punëtori dhe diskutim mbi temën :“*Sfidimi i normave gjinore në shëndetin mendor*”
 🚦 **Vendi: Biblioteka e Qytetit**
 - Aktivitet Kulturor: “Pikturë”
 🚦 **Vendi: Zyra e KFOR-it, Obiliq**
 - Aktivitet rekreativ-sportiv – NOT
 🚦 **Vendi: Pishina Zenit**
 - Edukim sportiv : *Trajnim dhe gara në Atletikë*
 🚦 **Vendi: Palestra e Sporteve “Adem Jashari”**
 - Aktivitet sportiv ajror; Paragliding,
 - Aktivitet sportiv motorik; “Parakalim i Motoçiklistëve”
 - Muzikë argëtuese në Sheshin e Qytetit
-

- **“Në dritë të mendjës”** u mbajt trajnimi rreth edukimit të shëndetit mendor me të rinjtë e komunës së Obiliqit. Trajnimi u udhëhoq nga profesionistët e shëndetit mendor, profesorët z.Fitim Uka dhe znj.Verona Perçuku dhe u mbështet nga Drejtoria e Kulturës.
 - Në Pallatin e Sporteve “ Adem Jashari” janë zhvilluar ushtrimet dhe provat e klubeve të ndryshme sportive, duke përfshirë disiplina të ndryshme si klubet e basketbollit, volejbollit, futboll. Klubet kanë ndjekur orarin e tyre të ushtrimeve në mënyrë të rregullt, duke respektuar orarin e përcaktuar sipas DKRS.
 - Ne palestrën sportive “ Adem Jashari” u organizuan garat komunale në futsallit, ku nxënësit nga shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Obiliqit shfaqën performance të shkëlqyer sportive.
 - Qendra Rinore Obiliq, në kuadër të shumë aktiviteteve vjetore, ka realizuar edhe aktivitete vetedijesuese rreth kancerit të gjirit, “Kancerin e Gjirit e Mposhtim së Bashku” aktivitet i realizuar në Shtëpinë e të moshuarve në Obiliq. Aktivitet u realizua në bashkëpunim me QKMF Obiliq dhe me përkrahjen e projektit nga DKRS.
 - Ne bashkëpunim me KFOR-in Amerikan, realizuan një aktivitet me të rinjtë që u përfshi dy tema kryesore:
 1. 5 Dhjetori-Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit
 2. 16 Ditë Aktivizem kundër Dhunes në baza gjinore.Aktivitet u mbajtë në shtëpinë e kulturës “Xhavit Haziri” –Obiliq, pjesëmarrës ishin edhe dy shkollat e mesme, Gjimnazi 17 shkurti, dhe Ismail Dumoshi.
 - Organizata “Dëgjo Zërin Tim” aktivitet kushtuar Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara. Ku fëmijët në bashkëpunim me mësuese patën mundësin të përgadisnin kartolina, dhe me parat e fituara nga shitja e kartolinave ata të organizojnë edhe disa aktivitete të tjera.
-

Ojq-ROMA press Service

- Program i organizuar me qëllim të promovimit dhe shpalosjes së trashëgimisë së pasur kulturore të komunitetit rom.
Programi artistik përfshiu këngë tradicionale romë, poezi që perqan mesazhe të fuqishme rreth identitetit dhe vlerave të komunitetit rom.

Premiera e baletit “TERMINAL” nga Baleti Kombëtar i Kosovës.

- Mbështetur nga drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

“Will You Merry Me”

- Premiera e shfaqjes “Will You Merry Me” filmi i shkurtër artistik, i zhanrit dramë, trajton temën e personave me aftësi të kufizuara dhe sfidat që ata përballojnë në shoqëri.
Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi në fjalën e tij, theksoi rëndësinë e krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët.

Festa e Flamurit

- Nën patronatin e Kryetarit të Komunës, dhe drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport u shënuan aktivitetet e shumta për nder të ditës së pavarësisë së Shqipërisë.
Homazhe tek shtatorët e heronjve të vendit dhe tek memoriali Adem Jashari në Prekaz.
Manifestimi vazhdoi me një program të pasur artistik, organizuar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, në bashkëpunim me Ansamblin e Këngëve dhe Valleve “AKV Qyteti I Obiliqit”.

“Okarinat”

- Në shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri” u mbajt koncerti i Korit të Fëmijëve “Okarinat”.
Në një bashkëpunim me organizuesit dhe Drejtorinë e Kulturës, fëmijët e shkollave fillore klasës 1-5 patën mundësinë të shohin provën gjenerale të koncertit.
Në kuadër të drejtorisë janë zhvilluar edhe disa aktivitetet, akademi, homazhe gjatë gjithë vitit që lëmë pas.
-

DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtoria e Arsimit **në raportin vjetor 2024**, punët dhe detyrat i ka kryer në bazë të Planit të Punës për vitin 2024 dhe detyrat tjera, të cilat janë marrë nga DKA dhe MASHTI. Janë mbajtur takimet e rregullta me Bordin e Drejtorëve Komunal, drejtorët e institucioneve arsimore, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, punëtorët e DKA-së dhe takimet me OJQ-të për projektet e arsimit.

Nga nëpunësit civil të DKA-së janë hartuar planet e punës për vitin 2024. Gjatë muajit janar janë kryer vlerësimet e punëtorëve për vitin 2023 në Sistemin e Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBN-HRMIS), ku nota mesatare e vlerësimit të nëpunësve për detyrat dhe aktivitetet është 4.9. Janë vlerësuar edhe drejtorët e zëvendësdrejtorët e SHFMU dhe SHML, ku nota mesatare e vlerësimit për vitin 2023 është 4.43.

Organizimi i procesit mësimor në gjysmëvjetorin e parë dhe të dytë 2023-2024 dhe 2024-2025

Arsimi në Komunën e Obiliqit organizohet në katër nivele 0,1,2,3 në këto fusha: Menaxhimi i arsimit; Gjithëpërfshirja dhe ngritja e sigurimit të cilësisë; zbatimi i kurrikulës së re; mjedisi i shkollës dhe zhvillimi i arsimit profesional. Shkollat mësimin e zhvillojnë, jo vetëm në klasa, por edhe në punëtoritë për praktikë profesionale dhe në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), KEDS Academy (vlenë të ceket se 16 nxënës të SHMLP”Ismail Dumoshi” në Obiliq janë radhitur ndër më të mirët në program të KEDS dhe janë duke e mbajtur praktikën profesionale), Viva Fresh Store, Monting, kabinetet e informatikës, kabinetet e fizikës, kimisë, biologjisë, matematikës, historisë dhe gjeografisë, duke përdorur vazhdimisht mjetet didaktike që kanë shkollat. Në paralelet e ndara, ku nuk kemi hapësira për kabinete mjetet mësimore janë vendosur në kënde të ndyshme shkollore si dhe në klasa mësimore. Me ndërtimin e sallave të edukatës fizike, ora e edukatës fizike zhvillohet në kushte bashkëkohore. Mësimdhënësit dhe nxënësit orët e mësimit nga fusha e kurrikulës - edukatë fizike, sportet dhe shëndeti i zhvillojnë në salla të edukatës fizike.

Gjysmëvjetori i parë i vitit shkollor 2023/2024 ka përfunduar më 12.01.2024. Gjysmëvjetori i dytë ka filluar më 25.01.2024 (sipas Udhëzimit Administrativ të MASHTI-it Nr.21/2023). Gjysmëvjetori i dytë ka përfunduar më 16 maj 2024 për klasët e 12 -ta, më 6 qershor për klasët e 9,10 dhe 11-ta. Më 24 qershor 2024 për klasët 1-8 dhe fëmijët parashkollor.

Gjysmëvjtori i parë i viti shkollor 2024/2025 ka filluar më 02.09.2024 në të gjitha nivelet, ku DKA me kohë ka bërë përgatitjet teknike në infrastrukturë, inventari shkollor në disa shkolla (sipas kërkesave dhe nevojave të shkollave). Janë shpërndarë mjetet higjenike, dokumentacioni pedagogjik dhe mjetet tjera shkollore (si shkumbësa, shpuza dhe markera). Janë duke vazhduar lyrjet (gëlqerosjet) e brendshme të disa shkollave (sipas nevojës). Para se të fillojë viti i ri shkollor nga DKA janë vizituar të gjitha shkollat dhe është punuar raporti për nivelin e pastërtinë në të gjitha institucionet edukative-arsimore, duke pasqyruar kështu gatishmërinë e shkollave edhe në nivel pastërtie për fillimvit.

Me rastin e fillimit të vitit ri shkollor 2024/2025 janë vizituar të gjitha shkollat nga kryetari i komunës z.Xhafer Gashi, nga stafi i DKA dhe NPL “Kastrioti”, për të uruar një vit të mbarë dhe për të parë nga afër gjendjen e objekteve shkollore. Gjysmëvjtori i parë vitit shkollor 2024/2025 ka mbaruar më 24.12.2024, ndësa gjysmëvjtori i dytë ka filluar më 08.01.2025.

Numri i nxënësve për vitin shkollor 2023/2024

Nr.	Shkolla	Shqiptar						Ashkali			Rom			Serb			gjithsej		
		Mashkull	Femër	gjithsej	Mashkull	Femër	gjithsej	Mashkull	Femër	gjithsej	Mashkull	Femër	gjithsej	Mashkull	Femër	gjithsej	Mashkull	Femër	gjithsej
1	"Rrita Jonë"	36	44	80	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	36	44	80
2	"Fazli Grejgevci" - Hade	24	12	36	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	24	12	36
3	'Fazli Grejgevci" - Palaj	19	27	46	0	0	0	9	11	20	0	0	0	0	0	0	28	38	66
4	'Fazli Grejgevci" - Lajthishtë	45	42	87	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	45	42	87
5	GJIMNAZI,,17 SHKURTI"	98	179	277	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	98	180	278
6	"Hasan Prishtina"	294	258	552	0	0	0	14	9	23	0	0	0	0	0	0	308	267	575
7	"Hasan Prishtina"-1	42	34	76	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	42	34	76
8	Migjeni- Siboc	83	67	150	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	83	67	150
9	Migjeni-Graboc I Eperm	18	18	36	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	18	18	36
10	SHFMU "Naim Frashëri" Breznicë	92	98	190	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	92	98	190
11	SHFMU "Naim Frashëri" Kozaricë	32	35	67	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	32	35	67
12	SHFMU "Abdurrahmon Gërguri" Dardhishtë	58	63	121	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	58	63	121
13	SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" Obiliq	453	457	910	0	0	0	10	9	19	0	0	0	0	0	0	463	466	929
14	SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" Mazgit I Lartë	80	76	156	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	80	76	156
15	SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" Mazgit I Ulët	120	112	232	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	120	112	232
16	SHFMU "Pandeli Sotiri" Obiliq I Vjetër	100	93	193	0	0	0	2	3	5	0	0	0	0	0	0	102	96	198

17	SHFMU "Pandeli Sotiri" Plemetin	20	16	36	0	0	0	76	62	138	0	0	0	0	0	0	96	78	174
18	SHMLP "Ismajl Dumoshi" Obiliq	254	81	335	0	0	0	3	1	4	0	0	0	0	0	0	257	82	339
19	SHFMU "Sveti Sava" Plemetin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	91	107	198	37	31	68	128	138	266
20	SHFMU "Millan Rakiq" Babimost	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	32	32	64	32	32	64
21	SHFMU "Dositej Obradoviq" Palaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	24	26	50	24	26	50
22	SHMLP "Sveti Sava" Plemetin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	20	41	61	40	30	70	60	71	131
	Gjithsej	1868	1712	3580	0	0	0	114	96	210	111	148	259	133	119	252	2226	2075	4301

Numri i nxënësve është 4301 sipas komunitetve: shqiptar janë 3578, serb 252, rom 259, ashkali 210 dhe boshnjak 2. Janë 247 paralele; 19 paralele me parafillor dhe me 228 paralele 1-5, 6-9 dhe 10, 11 dhe 12.

Numri i punëtorëve të arsimit në dhjetor 2024 është 396 punëtorë; prej tyre 10 drejtorë, 2 zëvendës drejtorë, 311 mësues, 2 sekretare, 3 psikologe, 1 logopede, 6 asistente për fëmijët/nxënës me nevoja të veçanta, 1 administratë, 54 punëtorë teknik (një nga ta është me nevoja të veçanta e gjinisë femer), 4 bibliotekarë (një nga ta me nevoja të veçanta i gjinisë mashkullore) dhe 2 kuzhinierë. Numëri i punëtorëve ndryshon gati çdo muaj për shkak të

pushimeve të lehonisë dhe pushimeve tjera. Numri i të punësuarve është 396 prej tyre meshkuj 116 dhe femra 280.

Nr	Institucione Arsimore	Drejtor	Zv.drejtor	Bibliotekarë	Pedagog sekretar	Psikologe logopede	Asistentë	Admini.	P.teknikë	Mësimdhënës	Servisuese	Gj.	M	F
1	IP"Rrita Jonë"	1						1	1	9	2	14	0	4
2	"Dr.Ibrahim Rugova"	1	1	1	1	2	3		10	79		98	19	79
3	"Hasan Prishtina "	1	1			1	1		7	40		51	14	37
4	"Pandeli Sotiri"	1					1		7	24		33	8	25
5	"Naim Frashëri"	1							4	24		29	11	18
6	"Migjeni "	1		1					3	23		28	14	14
7	"Abdurrahmon Gërguri"	1							2	14		17	6	11
8	"Fazli Grajqevci"	1					1		3	31		36	7	29

9	“17 Shkurti”	1						2	13		16	6	10
10	“Ismail Dumoshi”	1		2		1		1	7	34	46	20	26
11	“Sveti Sava”								12		12	5	7
12	“Dositej Obradovi q”							2	4		6	2	4
13	“Milan Rakiq”							6	4		10	4	6
Gj		10	2	4	2	4		2	54	311	2	396	1160

Gjatë kësaj periudhe janë bërë pagesat për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për nxënës dhe nxënës me nevoja të veçanta, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, bursave të nxënësve me sukses të shkëlqyeshëm për shkollat e mesme të larta dhe studentëve të nivelit bachelor dhe master për vitin shkollor dhe akademik **2023/2024**.

Subvencionet e DKA-së për vitin shkollor dhe akademik 2023/2024

Nr.	Ndarja e subvencioneve	Numri i konkurusëve	Numri i përfituesve	Mjetet e ndara	Meshkuj (përfitues të subvencioneve)	Femra (përfituese të subvencioneve)
1	Bursa për nxënës të SHML me sukses të shkëlqyeshëm	101	81	14,580.00 €	28	53
2	Bursa për studentë të nivelit bachelor	227	176	111,300.00	39	137
3	Bursa për studentë të nivelit master	66	51	5,1000.00 €	15	36
4	Bursa të nivelit të doktoraturës	1	0	0	0	0
5	Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit për nxënës me nevoja të veçanta	36	36	28,890.00 €	21	15
6	Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit për nxënës të SHFMU dhe SHML	944	764	103,140.00 €	338	426
Gj:		1339	1108	308,910.00 €	441	667

Studentja **Shqiponjë Rama** në Fakultetin Ekonomik, ka pasur notën më të lartë gjatë studimeve dhe ka fituar çmimin “Adem Preniqi” në vlerë prej 1400 €.

Komuna e Obiliqit, Drejtoria e Arsimit për vitin shkollor 2023-2024 organizon transportin edhe për një numër të nxënësve në vlerë prej 16,921.92 €, për nxënës që jetojnë në Zonën e Interesit Nacional, të shpallur nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Hade dhe Graboc). Në Shpitullë janë 10 nxënës që barten në SHFMU”Migjeni“ në Graboc dhe 2 nxënës janë në Hade, që vijojnë mësimin në SHFMU”Fazli Grajqevci “ në Palaj. Transporti organizohet edhe për nxënës që janë të rr ezikuar në komunikacion, të cilët janë të lagjes “Mavriqi” – “Hade e Re’, ku janë 9 nxënës.

Për transportin e nxënësve shqiptar dhe serb janë edhe dy minibusa të komunës, të cilët bartin nxënësit nga Babimoci, Llazareva dhe Lagjja “Grajqevëci” për në SHFMU ”Hasan Prishtina”, në Milloshevë. Nga vendbanimi Babimoc, barten 100 nxënës, nga Llazareva 30 nxënës, nga Lagjja “Grajqevci” 40 nxënës dhe nga NjanaVoda, në Palaj në SHF”Dositej Obradoviq” barten edhe 23 nxënës serb vetëm në njërin ndërrim (kthimin në shtëpi pas mësimit)

Planifikimi i projekteve të DKA-së dhe planet e prokurimit për vitin 2024

Nr	Shkolla	Vendi	Projektet (datat e parapara për prokurim)	Relizimi nga komuna /DA
1	SHMLP“Ismail Dumoshi”	Obiliq	Ndërtimi i Aneksit të shkollës në SHMLP”Ismail Dumoshi” në Obiliq (projekti ka përfunduar në gusht 2024)	DA
2	Institucionet Arsimore	Obiliq, Milloshevë, Raskovë, Mazgit, Plemetin, Hade, Palaj, Lajthishtë, Siboc,Graboc, Breznicë, Kozaricë, Dardhishtë dhe Babimoc	Material higjenik për shkolla (projekti është realizuar në shkurt 2024)	DA
3	IP”Rrita jonë” dhe DKA	Obiliq	Ushqim dhe pije për IP”Rrita jonë” dhe DKA (shkurt –dhjetor 2024)	DA
4	Institucionet Arsimore	Obiliq, Milloshevë, Raskovë, Mazgit, Plemetin, Hade, Palaj, Lajthishtë, Siboc,Graboc, Breznicë, Kozaricë, Dardhishtë dhe Babimoc	Dru dhe pelet nëpër shkolla (mars 2024) projekti është në përfundim të procedurave tenderuese dhe gjatë tetorit 2024 pritet të realizohet	DA
5	Institucionet Arsimore	Obiliq, Milloshevë, Raskovë, Mazgit, Plemetin, Hade, Palaj, Lajthishtë, Siboc,Graboc, Breznicë, Kozaricë, Dardhishtë dhe Babimoc	Kabinetet për shkolla (matematikë, gjeografi, histori dhe edukatë fizike) (prill 2024), projekti është realizuar në shtator 2024	DA
6	Institucionet Arsimore		Blerja e dy minibusëve (për transportin) të nxënësve të shkollave të komunës	DA

			(shkurt- mars 2024), Projekti është realizuar në qershor 2024	
7	Institucionet Arsimore	Obiliq	Digjitalizimi i SHMLP “Ismail Dumoshi” dhe Gjimnazit “17 Shkurti “ në Obiliq <i>(17.03.2023), projekti është në procedurë të prokurimit</i>	DA
8	SHFMU”Naim Frashëri “ në Breznicë	Breznicë	Ngritja e një pllake falenderimi në SHFMU”Naim Frashëri “ në Breznicë (prill 2023) , projekti është duke u realizuar, pritet të përfundoj në tetor 2024.	DA
9	SHMLP“Ismail Dumoshi”	Obiliq	Paisje për punëtorë në SHMLP”Ismail Dumoshi “ në Obiliq 2024)	DA
10	SHFMU”Dr. Ibrahim Rugova “	Obiliq	Projekti “ Shtruarja e dysHEMEVE të klasëve të shkollës dhe salsportive me epoxit në SHFMU”Dr.Ibrahim Rugova “ në Obiliq, projekti është duke përfunduar, pritet të përmbyllet gjatë muajit tetor 2024	Donacion nga Qeveria Japoneze-Ambasada Japoneze në Kosovë

Planifikimi i projekteve të DKA-së dhe planet e prokurimit për vitin 2025

Nr.	Shkolla	Vendi	Projektet (datat e parapara për prokurim)	Vlera e parashikuar e kontratës
1	SHMLP“Ismail Dumoshi”	Obiliq	Material shpenzues për punë praktike për SHMLP”Ismail Dumoshi”në Obiliq (mars 2025)	20,000.00 €

2	Institucionet Edukativo-Arsimore	Gjitha venbanimet , ku janë IEA	Furnizimi dhe mointimi i paisjeve,mjete të konkretizimit për nxënës me nevoja të veçanta (prill 2025)	18,371.00
<i>21.Azhurim i Gjendjes në Grafik</i>	<i>10</i>
<i>22.Lirim nga Barra Tatimore</i>	<i>7</i>
<i>23.Urdhër nga Përmbaruesi</i>	<i>2</i>
<i>24.Marrëveshje Ndërmjetësimi</i>	<i>4</i>
<i>25.Regjistrim i Vërejtjes gjyqësore</i>	<i>0</i>
<i>26.Fshirje e Vërejtjes Gjyqësore</i>	<i>0</i>
<i>27.Përcaktim i Kufijve</i>	<i>5</i>
<i>28.Regjistrim Parcele</i>	<i>12</i>

RAPORTI VJETOR-2024

	çertif.paluajtshmerisë	Kopje plani	çert.gjendj pronësore
--	------------------------	-------------	-----------------------

kërkesa	1731	1321	796
te realizuara	1690	1299	131
procedur	2	1	0
me bllok	4	3	0
lirume	35	18	665
totali	4840€	3916	295€
totali i përgjithshëm	9051€		

Te Hyrat Vjetore Janar-Dhjetor 2024 në Sektorin e Gjeodezisë Pronë dhe Kadastër janë: 61,980€ + 9051 € Cert.paluaajtshmërisë , Kopje Plani dhe Cert.gjendje pronësore , Gjithsejt të hyra = 71,031 €.

- Numri i Bartjes së Pronës në emër të dy Bashkëshortëve ka qenë 34 ;
- Numri i Bartjes së Pronës në emër të Meshkujve 181 dhe;
- Numri i Bartjes së Pronës në emër të Femrave 56 .

-SEKTORI I KADASTRIT-

- Si piknisje Sektori i Kadastrit kujdeset për respektimin e ligjeve dhe mbanë përgjegjësi për ligjet e Kadastrit dhe udhëzimeve administrative të nxjerra nga AKK, dhe se bashku me t'a krijojnë metoda në avansimin e punës.

- Gjatë këtij viti kemi punuar ne realizimin e te gjitha kërkesave për qytetarët e Komunës, varësisht prej llojit dhe natyrës së kërkesave të qytetarëve.

- Zhvillimin e procedurave të regjistrimit , sipas detyrës zyrtare dhe kërkesës së palëve;
- Korigjimin e regjistrit (SIKTK-së) sipas procedurave dhe zbatimin e te gjitha dispozitave ligjore në fuqi;

- Regjistrimin e pronave të paluajtshme dhe regjistrimin e pronave komunale;

- Azhurimin e pronave ,në bazë të dokumentacionit të lëshuara nga Gjykatat, Noterët, Përmbaruesit si dhe organet përgjegjëse Vendimet e Kuvendit, Vendimet nga AKK si dhe vendime tjera etj;

- Zbatimin e procedurave rreth transaksioneve të pronave private dhe shoqërore në SIKTK-së

- Shqyrtimin dhe kryerjen e procedurave administrative për rikthimin e paluajtshmërisë ish-pronarit, evidentimin dhe shlyrjen e masave të përkohshme sipas aktvendimit të Gjykatës kompetente;

- Udhëheqjen me kadastrë etazhë të banesave ,ndërtesave , pjesëve të ndërtesave si dhe ngastrat kadastrale ne të cilat janë ndërtuar banesat;

- Regjistrimin dhe çregjistrimin e hiptekave ; Aktvendimeve mbi regjistrimin e servituteve, regkstrimin e barrave tatimore;

- Lëshimin e certifikatave personave që nuk kanë patundshmëri, certifikatave mbi te drejtat e pronës se paluajtshme si dhe kopje planit;

- Mirmbajtjen, korigjimin dhe harmonizimin e evidencave të vendbanimeve ,fshatrave ,shesheve,rrugëve dhe numrat e objekteve dhe ndërtesave;

- Nxerrjen e aktvendimeve për miratim e ndarjeve të parcelave, Legalizimin e ndërtesave bashkimin e parcelave modifikimin e attributeve të parcelave, ndërtesave pjesëve të ndërtesave apo refuzim të kërkesave;

- Nxerrjen e konkluzioneve për plotësimin e kërkesave të pakompletuara;

- Përgaditjen e projektprogramit të punës për nevojat e Drejtorisë dhe raportin punës;
- Punë të tjera në pajtim me dispozitat ligjore (shpalljet publike, kërkesat për nevojat e Kuvendit, të gjykatave dhe institucioneve tjera).
- Zhvillimin dhe organizimin e sistemeve kadastrale, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informatik për tokën dhe pronën;
- Regjistrimin e ndarjeve të parcelave dhe modifikimin e attributeve të parcelave, ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave.
- Kryerjen e punëve profesionale, të cilat dalin nga shërbimi gjeodezik (ndryshimet e bëra gjatë matjeve nga Hartat e Kosovës dhe bartjen e tyre në programin e SIKTK-së.
- Kryerjen e shërbimeve për shënimet e digjitalizuara (dhënien e kordinatave për teren);
- Si dhe Shërbime profesionale dhe shërbime të tjera, për subjekte dhe institucione të ndryshme;
- Si dhe për fund kemi marr pjesë në trajnime, seminare të ndryshme për zhvillimin e njohurive që të jemi sa më transparent në kryerjen e shërbimeve ndaj Qytetarëve të Komunës.
- Në përfundim të këtij raporti për vitin 2024 konstatojmë se kemi arrit t'i përfundojmë varësisht prej natyrës së lëndëve, Kontrata shitblerje, Kontrata Falje, Kontrata për ndarje fizike, Regjistrim të Hipotekave Fshirje të Hipotekave, Aktvendime nga MMPH-ja, Vendime të Ndërmjetësueseve, Aktvendime të Trashëgimisë, Aktvendime të Gjykatës, Masë të Sigurisë nga Gjykata, Regjistrim të barra tatimore, ndarje të parcelave, Legalizimin e ndërtesave, Bashkimin e parcelave, modifikimin e attributeve të parcelave, ndërtesave pjesëve të ndërtesave apo refuzim të kërkesave Vendime të ndryshme, Kërkesa të ndryshme, Certifikata mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Kopje Plani, Certifikata që nuk posedojnë Pronë duke ardhur në përfundim se gjatë vitit kemi realizuar gjithsejtë 4924 kërkesa.

-SEKTORI I GJEODEZISË-

Raporti përmban një përmbledhje në vija të trasha të punëve gjatë periudhës një vjeçare përkatësisht për vitin 2024. Në raport janë përfshirë punët e përfunduara nga sektori në aspektin profesional sipas kërkesave të parashtruara nga ana e Drejtorive të KK Obiliq të cilat lidhen drejtpërdrejtë me punë profesionale në teren e që janë situacione të ndryshme për nevoja të projektimit, matje të parcelave – kufijëve për ndërtimin dhe planifikimin e rrugëve, elaborate të shpronësimit dhe identifikime të ndryshme me matje.

Pasqyra e lëndëve të përfunduara në kuadër të mirëmbajtjes së rregullt të Kadastrit do të paraqitet me një tabelë të veçantë dhe do t'i bashkëngjisim këtij raporti ndërsa ky raport me shkrim do të përfshijë vetëm punët dhe shërbimet që janë kryer sipas kërkesave të Drejtorive brenda Komunës.

Gjatë periudhës 2024 është punuar shumë në legalizimin e objekteve sipas Ligjit për legalizim, objektet të cilat marrin Vendimin për Certifikate të Legalizimit regjistrohen në pjesën grafike dhe tekstuale të Kadastrit, në këtë proces janë legalizuar objekte në bazë të Vendimit për Certifikatë të Legalizimit gjithsejtë sipas zonave kadastrale me sa vijon:

- zk Babimoc.....2 (dy) objekte
- zk Krushevc.....3 (tri) objekte
- zk Mazgit.....10 (dhjetë) objekte
- zk Milloshevë.....14 (katëmbëdhjetë) objekte
- zk Obiliq.....14 (Nëntë) objekte
- zk Plemetin.....1 (një) objekt
- zk Llazarevë.....1 (një) objekt

Gjithsejtë **45 objekte** të regjistruara në kadastër në procedurë të legalizimit dhe procedurë të rregullt në bazë të lejes ndërtimore dhe aktvendimit për certifikatë të përdorimit.

Me kërkesën e Drejtorisë së Infrastrukturës gjatë periudhës gjashtëmuajore janë kryer punë nga lëmia e gjeodezisë ingjinerike dhe fusha e kadastrit, si matje për kanalizime dhe përcaktim të kufijëve të rrugës për punim. Ka pas mjaft aktivitete pune me përfaqësuesit e KEK-ut për përcaktimin e rrugës qarkore pasi që rruga ekzistuese është atakuar nga zgjerimi i minierës.

Në zk. Obiliq sipas kërkesës së Ministrisë së punës dhe Mirëqenies Sociale janë bërë matjet gjeodezike – situacioni i terrenit në parcelën kadastrale nr. 1885-0 e cila është në pronësi të Komunës së Obiliqit. Gjithashtu sipas kërkesës janë bërë matjet për ndërtimin e Xhamisë në zk. Obiliq lokacioni Hade e Re.

Në zk. Siboc me kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë parashtruar nga KEK-u janë bërë matjet e rrugës parcela kadastrale 1137-0 për nevoja të zgjerimit të rrugës për banorët e anës pasi që rruga ekzistuese që lidh fshatrat Shipitullë, Graboc i Epërm është atakuar nga zgjerimi i minierës së KEK-ut.

Në zk. Llazarevë janë bërë matjet e rrugës te Zona Industriale. Në zk. Krushevc me kërkesë të Drejtorisë së Infrastrukturës janë bërë matjet e kanalizimit për nevoja të projektimit.

Lëndët e punuara në pjesën grafike në mirëmbajtjen e rregullt të kadastrit.

Pasqyra vjetore e lëndeve nga Regjistri i Fletëparaqitjes 2024							
Zona Kadastrale	Ndarje	Bashkim	Shpronësim	Korrigjim Kufirit	Rregullim	Ndërtesa	Total
Babimoc	8	1	1	-	1	2	13
Bakshi	4	-	-	-	-	-	4
Breznicë	5	3	-	-	-	-	8
Caravodicë	1	1	1	-	1	-	4
Graboc i Epërm	2	-	-	-	1	-	3
Hade	1	1	1	-	-	-	3
Hamidi	3	1	-	-	-	-	4
Kryshevc	10	2	2	-	5	3	22
Leshkoshiq	3	-	-	-	-	-	3
Llazarevë	8	-	2	-	1	1	12
Milloshëvë	16	1	1	-	3	16	37
Mazgit	19	6	2	-	4	10	41
Obiliq	22	4	-	3	10	12	51
Plemetin	12	1	-	-	2	1	16

Raskovë	15	-	-	-	1	-	16
Siboc	19	2	-	-	4	-	25
Shipitullë	7	1	-	-	-	-	8
Total	155	24	10	3	33	45	270

-SEKTORI I URBANIZMIT-

-Gjatë vitit 2024 Sektori i **Urbanizmit** në kuadër të DPUPK ka qenë i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme që kanë qenë të paraparë me planprogram si ato në zgjidhjen e kërkesave të palëve, përgjegjësit brenda Komunës, pjesmarrjet në takime jashtë komunës, pastaj trajnimet e ndryshme, e shumë punë të tjera të lidhura me këtë sektor, ku të gjitha këto fushëveprime janë përmblyllur me sukses gjatë këtij gjashtëmujori.

-Plotësimi I formularëve të performancës kërkesë nga komisioni komunal i performancës.

-Pjesmarrja në trajnimin nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me procesin e fillimit të Hartimit të Planit Hapësinor të Kosovës.

-Pjesmarrja në trajnimin e organizuar nga OSB-eja lidhur me procedurat e paisjes apo mos paisjes me vendim të legalizimit, si dhe vështërsit e hasura në procedurat e paisjes me vendime të legalizimit.

-Takime pune me MMPHI lidhur me problemet që kemi hasur lidhur me Hartimin e Hartës Zonale bashkarisht me Institutin e Planifikimit si dhe Ministrin linja që kanë të bëjnë me HZK-në.

Gjatë hartimit të këtij dokumenti qëllim kryesor ka qenë që të gjejmë zgjidhje për qytetarët tanë, duke u munduar të bëjmë zgjedhjen këyësore qështjen e banimit, duke ditur se Komuna e jonë është mbi 70% zonë e interesit të veçantë, është problem sigurimi për qështjen e banim dhe plotësimin e nevojave qoftë primare, sekondare e besa ndoshta edhe të atyre elementare. E vetmja Zonë e cila ka qenë e paraparë për vendosjen e banorëve nga Zonat e Mihjeve Sipërfaqësore ka qenë Lokacioni në Shkabaj në lagjen “Hade e e Re”, Mirëpo tani as këtë lokacion nuk e kemi sepse me Projektin e Bankës Botërore në bashkëpunim me Qeverin e Kosovës për “Solar 4”, ky projekt është vendosur në këtë Lokacion, që dmth të vetmen mundësi për banorët e zhvendosur më nuk e kemi. Jemi munduar që ta shfrytëzojmë mundësin për dendësin më të madhe, pasi kryesisht interesimi i banorëve të zhvendosur është drejt qendrës së qytetit, prandaj duhet të merret parasysh kjo qështje që të mos ketë bariera në zhvillimin e qytetit sa i përket ndërtimeve të larta, pasi si zgjidhje e vetme dhe e mundëshme është kjo mundësi.

Në kuadër të këtij projekti Komuna e Obiliqit ka formuar komision profesional të përbërë nga anëtarë të të gjitha drejtorive të KK Obiliq si dhe duke kyqur edhe akterët tjerë që janë të atakuar me këtë project.

Kemi filluar me punë nga korrik i vitit 2021 duke vazhduar me takime të njëpasnjëshme e duke kaluar nëpër qdo fazë të përcaktuar me ligj.

-Kemi organizuar takime me qytetarë duke filluar nga zona urbane dhe kemi vazhduar edhe në zonat rurale. Së pari kemi bërë njoftime për qytetar që ata të jenë të njoftuar për takimet, në mënyrë që të jenë prezent dhe së bashku ti përcaktojmë detajet dhe normat e zhvillimit në tërë teritorin e Komunës sonë së bashku me qytetarët.

Pas takimeve të njëpasnjëshme me qytetarë dhe harmonizimit të mendimeve me ta, Komuna e Obiliqit ka pasur edhe një takim me të gjitha biznese e Komunës duke filluar nga bizneset e vogla deri te ato të mëdha, ku përmes njoftimit publik ju ka bërë ftesë bizneseve të cilat i'u kanë përgjigjur kërkesës tonë masivisht dhe pjesëmarrja ka qenë mjaft e madhe nga ta. Duke ditura se në Komunën tonë kemi KEK, KEDS, KOSST, pastaj zonën industriale ku janë të koncentruara një numër i madh i bizneseve nga të gjitha anët e po ashtu edhe kompani të jashtme, ka qenë nevojë e domosdoshme një takim i tillë, sepse harmonizimi i interesave të përbashkëta me ta do të jet një përfitim i madh si për komunën tonë ashtu edhe për qytetarët e saj.

Kemi përgatitur edhe raportin e VSM-së , projekt në kuadër të HZK-së të cilin e kemi prezantuar para qytetarëve. Ky projekt ka qenë 30 (tridhjetë) ditë në shqyrtim publik dhe pasi nuk pati vërejtje, sygjerime apo ndonjë koment nga qytetarët apo grupet tjera të interesit, dokumenti është kompletuar dhe dorëzuar për shqyrtim në MMPHI-në , për të na pajisur me pëlqim për të vazhduar më tutje në draftimin final të dokumentit të Hartës Zonale. Komuna ka marrë Vendimin për Pëlqim Mjedisor për Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale për Komunën e Obiliqit më datën 08.02.2024 me numër protokoli 5380-2/23 nga MMPHI-ja.

Njëkohësisht rreth këtij dokumenti Komuna jonë ka organizuar një punëtori treditore në Republikën e Shqipërisë, respektivisht në Pogradec me pjesëmarrjen e anëtarëve të MMPHI-së, anëtarët e MBZHR, si dhe prezencën e Kryetarit të Komunës, kompaninë projektuese, komisionin komunal të komunës.

Kjo punëtori ka qenë mjaft produktive sepse i është dhënë kahja përfundimtare draftimit të këtij dokumenti duke u inkorporuar të gjitha pikat kyçe bashkërisht me Ministrin e linjës në mënyrë që ky dokument të finalizohet sa më shpejtë.

Kërkesë e përfaqësuesve të Ministrisë së MPHI ishte që të respektohet rregullativa ligjore si dhe të arsyetohet çdo veprim i marrë në dokument.

Tani kemi arritur në fazën përfundimtare ku pas një pune voluminoze me takime, prezantime para qytetarëve para grupeve të interesit, duke u munduar që çdo cep si të Zonës Urbane po ashtu edhe të asaj rurale të analizohet dhe të mundohemi që këtij dokumenti t'i japim një orientim sa më konkret dhe të zbatueshëm për qytetarët duke u bazuar në norma të planifikimit.

Shpresojmë të kemi arritur që dokumenti të jetë i zbatueshëm në teren duke plotësuar nevojat e qytetarëve , duke respektuar rregullat e përcaktuara në bazë të Normave të Planifikimit. Dokumenti është aprovuar me pëlqim për miratimin e Hartës Zonale nga ana e MMPHI-ja si dhe është miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit. Tani kemi të dy dokumentet e Planifikimit Hapësinor si Planin Zhvillimor dhe Hartën Zonale të Komunës së Obiliqit dhe kemi filluar me pajisjen me Vendime të lejeve ndërtimore për ata të cilët i plotësojnë kushtet në bazë të rregullativës ligjore.

-Poashtu janë kryer edhe punë të tjera që janë të lidhura me sektorin e urbanizimit, duke cekur edhe konsultimet me palë lidhur me punët që I takojnë natyrës së punës tonë.

-Më poshtë do të cekim lëndët që janë të lidhura me të hyrat në sektorin tonë.

- 8 vendime për leje ndërtimore,
- 9 certifikata të përdorimit,
- 2 vendim të refuzimit,
- 1 leje rrënimi,
- 36 përgjigjeje palëve,
- 10 njoftime për qytetarë në kërkesat e ndryshme.

- 17 vendime të legalizimit të objekteve
- 1 vendime të legalizimit për listë të pritjes.

Të hyrat nga lejet ndërtimore : 3 452.64 €
Të hyrat nga legalizimi i objekteve: 4 223.15 €

TOTAL 7 675.79 €

Sektori i Urbanizmit :	7675.79 €
Sektorët - Gjeodezi Pronë dhe Kadastër :	71,031 €
Totali :	78,706.79€

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Numri i të punësuarve në institucion sipas viteve dhe gjinisë					
Kategoria e zyrtarëve /Viti	Nëpunës të shërbimit civil	Nëpunës të shërbimit publik	Nëpunës Teknik dhe mbështetës	Krijues dhe performues të artit dhe kulturës	Zyrtarë të Kabinetit
2022	Gra	49		3	
	Burra	55		1	
	Gjithsej	104		4	
2023	Gra	63			5
	Burra	53			9+1 SERB
	Gjithsej	116			14
2024	Gra	57			6
	Burra	59			13
	Gjithsej	116			19

Të dhënat rreth nëpunësve të shërbimit civil në institucion gjatë tri viteve të fundit

Numri i të nëpunësve civil sipas kategorive dhe gjinisë						
Kategoria e zyrarëve /Viti		Kategoria e lartë drejtuese	Kategoria e mesme drejtues	Kategoria e ulët drejtues	Kategoria e specialistëve	Kategoria Profesionale
2022	Gra					
	Burra					
	Gjithsej					
2023	Gra			13	1	38
	Burra			16	3	32
	Gjithsej			29	4	70
2024	Gra			13	1	38
	Burra			16	3	32
	Gjithsej			29	4	70

Numri i nëpunësve civil me aktemërim/ ushtrues detyre gjatë vitit 2024				
		Kategoria e lartë drejtuese	Kategoria e mesme drejtues	Kategoria e ulët drejtues
Aketemërim	Gra			
	Burra			
Ushtrues detyre	Gra			2
	Burra			2

Ndryshimi i numrit të nëpunësve civil sipas kategorive gjatë vitit 2024				
Kategoria funksionale	Numri i nëpunësve civil në fillim të vitit 2024	Numri i nëpunësve civil të larguar nga SHC në vitin 2024	Vendet e plotësuara gjatë vitit 2024	Numri i nëpunësve civil në fund të vitit 2024
Kategoria e Lartë Drejtuese				

Kategoria e Mesme Drejtuese				
Kategoria e Ulët Drejtuese	29	1	1	
Kategoria profesionale	70	1	5	
Kategoria e specialistëve	4			
Gjithsej	103	2	6	101

Nëpunësit civil sipas nivelit të arsimit (ju lutem vendosni nivelin më të lartë të arsimit që ka një nëpunës)				
Kategoria funksionale	Arsimi i mesëm	Bachelor	Master	Doktoratë
Kategoria e Lartë Drejtuese				
Kategoria e Mesme Drejtuese				
Kategoria e Ulët Drejtuese		29		
Kategoria e Specialistëve		4		
Gjithsej		33		

Nëpunësit civil me aftësi të kufizuara			
Kategoria funksionale	2022	2023	2024
Kategoria e Lartë Drejtuese	/	/	/
Kategoria e Mesme Drejtuese	/	/	/
Kategoria e Ulët Drejtuese	/	/	/
Kategoria e Specialistëve	/	/	/
Gjithse	/	/	

Përkatësia etnike e nëpunësve civil						
Nacionaliteti	Kategoria e Lartë Drejtuese	Kategoria e Mesme Drejtuese	Kategoria e Ulët Drejtuese	Kategoria Profesionale	Kategoria e Specialistëve	Gjithsej
Shqiptarë			28	59	4	91
Serbë			1	9		10
Boshnjakë				1		1
Turq						
Goranë						
Romë				1		1
Ashkali						
Egjiptianë						
Tjetër						

Procedurat e Rekrutimit

Procedurat e rekrutimit			
Kategoria e zyrtarëve	Numri i shpalljeve	Numri i aplikantëve	Numri i personave të emëruar
Nëpunës i shërbimit civil	10	91	6
Nëpunës i shërbimit publik	43	176	20
Nëpunës teknik dhe mbështetës	2	5	2
Krijues dhe performues i artit dhe kulturës			
Gjithsej	55	272	28

Rekrutimi për nëpunësit e shërbimit civil gjatë vitit 2024			
Kategoria funksionale	Numri i shpalljeve	Numri i aplikantëve	Numri i personave të emëruar
Kategoria e Lartë Drejtuese			
Kategoria e Mesme Drejtues			

Kategoria e Ulët Drejtuese	1	7	1
Kategoria e Specialistëve			
Kategoria Profesionale	9 kokurse	84	5
Gjithsej	10	91	6

Procedurat e rekrutimit për nëpunësit civil gjatë vitit 2024						
Kategoria funksionale	Pozitat e planifikuara në planin e personelit 2024	Të përfunduara me sukses	Të dështuara	Të anuluar	Në proces	Gjithsej procedura të shpallura
Kategoria e Lartë Drejtuese						
Kategoria e Mesme Drejtues						
Kategoria e Ulët Drejtuese	1	1				1
Kategoria Profesionale	10	5	4			9
Kategoria e Specialistëve						
Gjithsej	11	6	4			10

Përfundimi i marrëdhënies së punës së nëpunësve civil /2024

Përfundimi i marrëdhënies së punës për nëpunësit civil gjatë vitit 2024 sipas kategorive dhe arsyes					
Arsyeja e përfundimit	Kategoria e Lartë Drejtuese	Kategoria e Mesme Drejtues	Kategoria e Ulët Drejtuese	Kategoria e Specialistëve	Kategoria Profesionale
Pensionim			1		1
Pensionim i parakohshëm					
Dorëheqje					
Dënim me vendim të formës së prerë					
Vdekje					

Paaftësi shëndetësore				
Lirim si rezultat i vlerësimit të performancës				
Arsye tjera (specifiko)				
Gjithsej			1	1

Përfundimi i marrëdhënies së punës për nëpunësit civil gjatë viteve 2022 - 2024			
Arsyeja	2022	2023	2024
Pensionim	4	2	2
Pensionim i parakohshëm	1		
Dorëheqje			
Dënim me vendim të formës së prerë			
Vdekje			
Paaftësi shëndetësore			
Lirim si rezultat i vlerësimit të performancës			
Arsye tjera (specifiko)			
Gjithsej	5	2	2

Vlerësimi i performancës për nëpunësit civil

Vlerësimi i performancës për nëpunësit civil gjatë vitit 2024	
Numri i nëpunësve të vlerësuar	Nuk ka perfunduar
Mesatarja e vlerësimit	

Transferimi i nëpunësve civil

Transferimi i nëpunësve civil gjatë viteve 2022 - 2024				
Numri i nëpunësve të transferuar	Transfer i përkohshëm	Transfer si pasojë e ristrukturimit	Transfer i përhershëm	Transfer për arsye tjera (të listohen arsyet)
2022			18	
2023			/	
2024			32	

Pushimet e nëpunësve civil gjatë vitit 2024

	Numri i kërkesave	Numri i ditëve
Pushim vjetor	251	251
Pushim mjekësor	63	63

Pushim pa pagesë	4	210
Gjithsej	317	524

Masat disiplinore për nëpunësit civil 2022 – 2024

Numri i masave ndaj nëpunësve civilë		2022	2023	2024
Masa për shkelje të lehta disiplinore				
Masat për shkelje të rënda disiplinore	Ndalimi nga 20% deri në 50% e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj (20 - 40% sipas Ligjit Nr. 06/L-114)	1	2	
	Ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite (2 - 5 vite sipas Ligjit Nr. 06/L-114)			
	Transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë	/		
	Ulja në pozitë	/		
	Pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj	/		
	Pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit	/		2
	Largimi nga shërbimi civil			

Trajnimet e nëpunësve civil

Kategoria funksionale	Kategoria e Lartë Drejtuese	Kategoria e Mesme Drejtues	Kategoria e Ulët Drejtuese	Kategoria i specialistëve	Kategoria Profesionale
Numri i stafit të trajnuar			3		6
Numri i trajnimeve në të cilat kanë marrë pjesë stafi			3		6

Njësi Antidiskriminim dhe Barazi Gjinore

Janar - Implementimi i projektit “Kultivimi i Bimëve Shëruese Aromatike” ku në këtë projekt përfshihen: trajnime me gratë për fushën e kultivimit të bimëve pajisje në sera të nënave vetëushqyese. Ky project do të realizohet me organizatën 99 lule (Serat do të mbështeten nga UNMIK-u.

Janar - U mbajt punëtorja aktiviteti qeverisja e pronës- USAID, ky aktivitet u mbajt me gra të viseve rurale.

Janar - U mbajt takimi i rregullt I mekanizmit koordinues kunder dhunes ne familje meqe rast diskutuam gjendja aktuale e rasteve të dhunes ne Komunen e Obiliqit.

Janar -Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Janar -Monitorimi i komitetit për financa

Janar -Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjinore :F: 9M:12

Janar- U mbajt takim i rregullt i grupit të grave.

Janar-Takimi me KFORI-in Zvicran ku u diskutuan të arriturat në fushen e barazisë gjinore për 2023-ten dhe planet për 2024-ten.

Shkurt - Takim me këshilltaren e Kryeministrit, për komunitete ku meqe rast diskutuam per gjendjen e grave dhe vajzave nga komuniteti pakice në Komunën tonë martesat e hershme, edukimi, punësimi, dhe bashkëpunimi për 2024-ten.

Shkurt - Filloj projekti BY GIRLS FOR GIRLS me vajzat e klasave të tetav dhe të nëntave, ky project ka për synim ti aftësoi vajzat në STEM, Projekti do të realizohet me shkollën fillore ‘Ibrahim Rugova’ dhe shkollën fillore ‘Pandeli Sotiri’.

Ky projekt do të realizohet me OJQ-në SHQIPONJAT E DARDANES (Kosova steem center). Shkurt – Pjesëmarrja në përrurimin e dhomës mike pranë stacionit policor ky projekt u mbështet nga KFORI.

Shkurt - Takim me antarët e performancës.

Shkurt - Pjesëmarrja në takimin e rregullt të KKSB-së

Shkurt -Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Shkurt -Monitorimi i komitetit për financa

Shkurt -Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjinore :F: 9M:12

Mbahet aktiviteti me nxënësit në shkollën fillore ‘Pandeli Sotiri’, aktiviteti BY GIRLS FOR GIRLS me vajzat e klasave tetave dhe të nëntave, para nxënësve u shfaq laborator i lëvizës ku nxënësit patën rastin të shohin teknikat e ndryshme në STEM. Në këtë aktivitet ishte present ambasadorja kanadeze.

Shkurt - Pjesëmarrja në puntorine dy ditore me antarët e kolegjiut për barazi gjinore organizuar nga Asociacioni i Komunave.

Mars – Takim me përfaqesuesen e OJQ-se Degjo Zerim tim takimi kishte për qëllim bashkëpunimi mes njesise tonë dhe OJQ-se, kordinimi I aktiviteteve për gjate vitit.

Mars – Filloj trajnimi i grave në agrobiznes kutivimi I bimeve sheruese aromatike(pjese e ketij projekti do te jene 12 gra), në trajnim nga agromedicine grate moren njohuri për trajtimin kultivimin e këtyre bimeve.

Mars – U mbajt takimi i rregullt i grupit të grave diskutim gjendja, e barazise, projektet, aktivitetet për vitin 2024.

Mars – Takim në zyre të Kryetarit me shefen e OSBE-së, takimi kishte për qëllim qeverisjen gjinore të Komunës dhe implemtimin e planit për barazi gjinore 2024-2026.

Mars – Filluam aktivitetet marsi muaji i grave

U realizua aktiviteti me gratë e viseve rurale ku u diskutua, perfshirja e grave në jetën publike dhe institucionale (u diskutua për gjendjen e jeteses).

Mars – Në bashkëpunim me kryesuesen e grupit të grave të Komunës sonë dhe Komunës se Lipjanit kemi realizuar panairin e grave me produkte tradicionale në Komunen e Lipjanit, ku meqe rast grate e të dyja Komunave shkëmbyen përvoja në këtë drejtim.

Mars – Vizitë në strehimore Qendra për mbrojtje të grave dhe femijeve në Prishtinë, në këtë vizitë u njoftuam nga Drejtoresha e Qendrës për gjendjen për punët dhe aktivitetet që zhvillohen nga viktimat për mbrenda qendrës dhe bashkëpunimi jone.

Mars - U realizua punetoria e radhës me grate me AGROMEDICINE dhe njesiti jonë gratë në agrobiznes, ku gratë u trajnuan për startimin e mbjelljes së fidaneve përgaditja e tokës etj.

Mars – Në ditën ndërkombëtare të gruas 8 MARSIT u organizua aktiviteti me nxënëset e shkollës së mesme ‘‘17 Shkurti’’ me temën thyerja e striotipeve gjinore, ky aktivitet u realizua nga nxeneset thyerjen e striotipeve gjinore e realizuam në forme të aktrimit, ky aktivitet u mbështet nga OSBE-ja.

Mars – Takim me organizaten EKO WOMEN takimi kishte për qëllim realizimi I projektit edukimi shendetësor, të drejtat e pacientit , project ky që do te realizohet në Komunen tonë.

Mars – U realizua takimi me përfaqësues të USAID-it – qeverisja e pronës, në këte takim ishin pjese grate e shoqeris civile të cilat operojne në Komunen tonë.

Mars – Aktivitet me gratë e shoqatës se pensionisteve në Komunën tonë, ‘‘ Ti ruajme traditat tona në punë dore dhe artizanale’’ meqe rast kerkuam nga grate pensioniste që të organizojme kurse me pune dore për grate e reja.

Mars -Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Mars -Monitorimi i komitetit për financa

Mars -Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjinore :F: 9M:12

Prill- Takim me përfaqesuesit e Qendres burimore për të pagjeturit, takimi kishte për qëllim, bashkëpunimi jonë i ndersjelltë.

Prill – Takimi I rregullt I mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje ku u diskutua gjendja e kësaj dukurie në Komunen tonë.

Prill – Pjesemarrja në takimin e rregullt të KKSB-së

Prill - Organizimi I puntorise me antarët e mekanizmit koordinues kundër dhunës në famnilje, punetoria kishte për qëllim realizimin e planit të punës të këtij mekanizmi

Prill – Në bashkëpunim me AGROMEDICINE bëhet shpërndarja e fidaneve bimëve shëruese aromatike tek gratë perpos bimeve tek keto grate janë shpërndarë edhe serat dhe sistemi i ujitjes te 7 gra.

Prill – Filloj shpërndarja e serave te gratë të cilat do të mirren me pemë dhe perime të imeta, tek 10 gra pjese e ketyre serave janë edhe tri gra nga Komuniteti Romë.

Prill-Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Prill -Monitorimi i komitetit për financa

Prill -Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjinore :F: 9M:12

Maj – Takim me KFOR-in qëllimi I takimit, gjendja e barazise, dhe e dhunës ndaj grave në Komunen tonë.

Maj – Realizimi i punetoris në Shqiperi i takimit në grupin punues të planit kunder dhunës në familje.

Maj – Vizite në Qendrën për promovimin e të drejtave grave në Drenas, takimi kishte per qellim shkembim pervojash mes nesh.

Maj – Takimi I rregullt me grupin e grave

Maj – Realizimi I tryezes per te drejtat e personave me nevoja te veqanta.

Maj -Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Maj-Monitorimi i komitetit për financa

Maj -Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjinore :F: 9M:12

Maj - Pjesemarrja në takimin e rregullt të KKSB-së

Qershor – Realizimi i planit të punës të mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje

Qershor - Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Qershor-Monitorimi i komitetit për financa

Qershor-Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjinore :F: 9M:12

Qershor – Pjesëmarrja në punëtorin dy ditore në Tirane, kjo punetori u realizua nga UN WOMEN me zyrtaret pjese e projektit të planit për barazi gjinore përfaqesuesit e Agjensionit për barazi gjinore dhe Ministria e Pushtetit Lokal.

Qershor - Pjesemarrja në punetorin buxhetimi I pergjegjshem gjinor, organizuar nga WIKWOMEN.

Qershor – U realizua aktiviteti me produktet ushqimore dhe punedore artizanale për nder të ditës së Komunës me gratë e Shoqatës së pensionistëve.

Qershor - U realizua aktiviteti shkëmbim përvajsh në mes të grave të Komunës së Obiliqit dhe grave të Komunës së Graçanices në Agrobiznes, ky aktivitet u mbështet nga AGROMEDICINE.

Korrik- U mbajt degjimi public, plani I veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2025-2027, pjese e ketij takimi ishin përfaqesues të OJQV-e dhe gra dhe vajza nga Komuna jone.

Korrik – U organizua punetori prezentimi i planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2025-2027, plani u paraqit për antarët e mekanizmit, ky aktivitet u mbështet nga OSBE-ja.

Korrik – Takim në Komunë e Istogut, takimi kishte për qëllim shkëmbim përvajsh mes të dy grupeve të grave.

Korrik – Takim me përfaqesues të GIZIT gjerman, takimi kishte për qëllim nevojat për realizim të projekteve.

Korrik – Takim me përfaqësues të OJQ-ve komunale.

Korrik - Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Korrik -Monitorimi i komitetit për financa

Korrik -Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjimore :F: 9M:12

Korrik - Pjesëmarrja në takimin e rregullt të KKSB-së.

Korrik – Pjesëmarrja në Komisionin për rekrutimin e punëtorëve me nevoja të veqanta.

Gusht – Takim me përfaqësuesit e Organizatës EKOWOMEN, takimi kishte për qëllim realizimin e takimeve themelimi i focus grupeve me gratë e viseve rurale e komunitetit pakicë.

Gusht – EKOWOMEN në bashkëpunim me zyrën tonë e realizuam aktivitetin me focus grupin e grave të qendrës së Obiliqit, qasja në kujdesin shëndetësor cilësor të grave, dhe të drejtat e pacientit.

Gusht – Aktiviteti EKOWOMEN në bashkëpunim me zyren tonë dhe qendrën rinore realizojë qasjen e kujdesit shëndetësor dhe të drejtat e pacientit me të rinjët dhe të rejtat e Komunës sonë.

Gusht - U realizua aktiviteti EKOWOMEN në bashkëpunim me zyrën tonë realizojë qasjen e kujdesit shëndetësor dhe të drejtat e pacientit me gratë e Milloshevës.

Gusht - Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Gusht-Monitorimi i komitetit për financa

Gusht-Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjimore :F: 9M:12

Shtator – Komuna e Obiliq- it ka realizuar projektin, furnizimi me piceta higjienike menstruale, për gratë në Administratën Komunale nxënëset e shkollave fillore dhe të mesme.

Shtator – U realizua takim me Drejtorinë e Shëndetësis dhe grupin e grave koordinimi për fushatën kundër kancerit të gjirit.

Shtator – Takim me përfaqësuesit e OSBE-së, takimi kishte për qëllim realizimi i aktiviteve(mbështetja nga OSBE-ja) me rastin e fushatës së 16-ditshit të aktivizimit.

Shtator - Monitorimi i seancës së kuvendit komunal
 Shtator-Monitorimi i komitetit për financa
 Shtator-Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjinore :F: 9M:12

Shtator – Organizimi I takimit me gratë e shoqatës së pensionistëve diskutim për të drejtën e tyre ne sherbimet shendetesore dhe te tjera.

Shtator – Takimi i rregullt me grupin e grave.

Tetor – U realizua takimi me stafin drejtues te Institutit Infinit Kosova, ky takim u realizua në kuader te projektit ‘‘Ngjyrat e humanizmit’’, pjese e aktiviteteteve që synojne avokimin për barazi gjinore dhe mosdiskriminimin project ky i cili do të vazhdojë edhe në 2025-tën.

Tetor – Në kuader të fushates kundër trafikimit me qenje njerezore eshte realizuar aktiviteti sesion informues me nxënësit e shkollave fillore mbi këtë fenomen.

Tetor - Është realizuar punëtori me përfaqësues të OJQ-ve dhe institucioneve loKale me temën ‘‘Rreziku nga trafikimi i mundëshem’’.

Tetor - Pjesëmarrja në takimin e rregullt të KKSb-së.

Tetor - Monitorimi i seancës së kuvendit komunal
 Tetor-Monitorimi i komitetit për financa
 Tetor -Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjinore :F: 9M:12

Tetor – Drejtoria e Shendetësis në bashkëpunim me zyren e Kryetarit të gjitha Drejtorite dhe zyren tonë kemi realizuar video inqizimin senzibilizues kundër kancerit të gjirit’’ Bashke për një shoqeri me të shendëtshme dhe me të forte’’.

Tetor – Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë me rastin e fushatës Tetori Rozë kemi realizuar takim informues dhe ndërgjegjësues me gratë dhe vajzat e Komunës së Obiliqit, pjese e ketij organizimi ishte edhe organizata ‘‘Jeta Vita’’ dhe Shoqata e Onkologëve të Kosovës.

Tetor – Organizimi i aktivitetit në bashkëpunim me rrjeti i organizatave të grave rome ashkali dhe egjipitiane kemi realizuar takim me gratë e këtij komuniteti për gjendjes e jeteses me këto gra, dhe luftimi kundër martesave të hershme.

Tetor – Muaji I barabarte për të gjithë kemi realizuar tryeze për persona me nevoja të veqanta me temen ‘‘Të gjithë të barabartë’’.

Tetor – Misioni I OSBE-se në Kosovë në bashkëpunim me Komunën tonë Graqanice, Dragash ka organizuar punëtori me perfaqësuesit e rrjetit të sigurise së grave Komuna jonë në këtë takim ka shfaqur sukseset si model e cila ka kontribuar në këtë drejtim.

Tetor – Eshte organizuar aktiviteti ‘‘te drejttat pronesore procesi I regjistrimit te prones dhe sherbimet kadastrale, ky aktivitet eshte mbeshtet nga Organizata KLARD pjese e këtij takimi ishin kryesisht gratë e viseve rurale.

Tetor – Takim mes Njesisë sonë Komunën e Prishtinës dhe Fushë Kosovës, takimi kishte për qëllim koordinimi I aktivitetit të përbashket me rastin e fushatës 16 ditet e aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore.

Nentor – Takimi me komisionin për ndarje të mirenjohjes zyrtari/ja i dalluar qytetari/ja e dalluar.

Nëntor – Pjesemarrja e punëtoris tri ditore në Tiranë, qellimi I punëtoris ishte shkëmbim përvojash mes Komunave të Kosovës(16 Komuna), Tiranë, Elbasan, Durrës, kjo punëtori u mbështet nga UNWOMEN.

Tetor-Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Tetor-Monitorimi i komitetit për financa

Tetor-Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjinore :F: 9M:12

Nëntor – Gjirimi i video-spotit i realizuar nga Agjensioni për barazi gjinore për rolin dhe përgjegjësitë e mekanizmave koordinues kundër dhunës në familje, gjirim ky i cili u lansua për fushatën 16 ditet e aktivizimit.

Nëntor – U bë hapja e fushatës 16 ditet e aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore meqe rast u vendos kordela e bardhe në institucionin komunal.

Nëntor – U hap ekspozita e nxënësve me punimet e punuara me motive të dhunës në familje dhe baza gjinore.

Nëntor – Aktiviteti I radhës me rastin e 16 diteve të aktivizimit Komuna jone pjese e organizimit të Ambasadës Amerikane e cila ka organizuar në shesh fushatë senzibilizuese kundër dhunës në baza gjinore pjese e ketij aktiviteti ishin edhe Komuna e Prishtinës, dhe e Fushë Kosovës.

Nëntor – Pjesemarrja në punëtorin tri ditore në Shkup, punëtori kjo e cila u organizua nga UNWOMEN me Komunat partnere me temën’’ Buxheti I përgjegjshem gjinor’’ të arriturat e Komunave në këtë drejtim, pjese e ketij organizimi përpos Komunave ishin edhe Zyra e Kryeministrit ABGJ, MAPL,MINISTRIA E FINANCAVE.

Nëntor – Pjesemarrja në KKSB.

Nëntor-Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Nëntor-Monitorimi i komitetit për financa

Nëntor-Monitorimi i komitetit për komunitete

Struktura Gjinore :F: 9M:12

Dhjetor - Takimi I rregullt I mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje.

Dhjetor – Në kuadër të fushatës së 16 ditet e aktivizimit kemi realizuar aktivitetin e radhës me nxenesit e shkollave fillore ‘’Pandeli Sotiri’’ në Obiliq dhe shkollën Migjeni në Siboc, në bashkëpunim me Prokurorine e Shtetit kemi informuar nxënësit për dhunen në familje, njoftimin për linjat ndihmëse për këte dukuri.

Dhjetor – Në kuadër të fushatës 16 ditet e aktivizimit është organizuar aktiviteti I radhës tryeza me temën ‘’Parandalimi i incidenteve të sigurise dhe ekstremizmit të dhunshem’’, këtë aktivitet e ka mbështetur OSBE-ja.

Dhjetor – Në kuadër të fushates 16 ditet e aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore këte fushatë e kemi përmyllur me aktivitetin e radhes fuqizimi ekonomik I rasteve te dhunes ne familje, meqe rast eshte organizuar Ekspozimi I punimeve të cilat punohen nga rastet e dhunës në familje të cilat qendrojnë në strehimore, dhe në këtë aktivitet kemi përkrahur rastet e dhunës në familje në fuqizimin ekonomik me blerjen e punimeve të tyre, kete aktivitet e ka mbështetur OSBE-ja.

Dhjetor – Pjesemarrja në punëtorin me temën Idete për aktivitetet për vitin 2025-te, kjo punëtori është organizuar nga OSBE-ja.

Dhjetor-Monitorimi i seancës së kuvendit komunal

Dhjetor-Monitorimi i komitetit për financa
 Dhjetor -Monitorimi i komitetit për komunitete
 Dhjetor-Në bashkëpunim me OJQ “Dëgjo Zërin Tim” dhe drejtorin e administrates kemi shpërnda dhurata për fëmijët me autizëm.
 Ky project u mbështet nga OJQ “Replay Place”
 Struktura Gjimore :F: 9M:12

-Aktivitetet e realizuara për vitin 2024 gjithesej kanë qenë :38 aktivitete

Nderrmarrja e masave të veçanta afirmative të cilat janë nderrmarre nga Komuna jonë: - Projekti pajisja me peceta higjienike menstruale për gratë dhe vajzat e komunës është një masë afirmative që synon të adresojë pabarazitë dhe të përmisojë qasjen në higjienë bazike.

Masa tjetër : Bazuar në Ligjin për Barazi Gjimore Nr.05/L-020,të Kosovës promovimi i barazisë gjimore në emertime publike,përfshirë rrugët ,shkollat ,sheshet dhe institucionet si bibliotekat,është mbështetur ligjërishtë . Nenit 6 i këtij ligji thekson që autoritetet publike duhet të sigurojnë përfaqësim të barabartë gjinor në emërtimin e hapsirave dhe institucioneve publike Komuna emërton Bibliotekën në emër të gjinis femrore .

Masa afirmative në punsim për persona me nevoja të veçanta në institucionet publike,në bazë të ligjit Nr.05/L078 për personat me aftësi të kufizuara,si dhe ligji I punës Nr.03/L212 komuna e Obliguar punson 3 persona me nevoja të veçanta duke respektuar ligjin për barazi gjimore (dy burra dhe një grua) duke e balancuar kuotën për persona me nevoja të veçanta

Zyra ligjore

Shërbimet ligjore të ofruara:

-**Këshilla juridike** ,për zyrën e Kryetarit, Drejtoritë komunale, sektoret ,auditorin e brendshëm, zyrën e personelit në përpilimin e akteve juridike,vendime,procedurat e shpronësimit,rrregulloret komunale të aprovuara në kuvend sipas propozimeve të drejtorive.

-Përpilimin e kontratave ,memorandumeve për zyrën e kryetarit dhe për të gjitha drejtorite, përpilimin e shkresave të ndryshme etj.

-Shqyrtimin e të gjitha kontratave të propozuara nga ana e drejtorive për bashkëpunim me organizatat e ndryshme para se të bëhet nënshkrimi i tyre.

-Përpilimin e vendimeve sipas kërkeses së Kryetarit dhe Drejtorive .

Përfaqsimet :Në bashkëpunim me Zyrtaret Ligjore dhe avokatin janë bërë mbi **1707 veprime** juridike –gjyqësore duke përfshirë Padite, shkresa ,përgjigje në padi,parashtresa të ndryshme për gjykatë, mbajtje të seancave gjyqësore si dhe sigurim të provave sipas kërkesës së gjykatave,prapsime tek permbaruesi menaxhimi i kontratës dhe shume veprime tjera.

-Pranimi i të gjitha lëndëve gjyqësore përmes arhivës ,shqyrtimin e tyre ,regjistrimin në regjister te evidences si dhe kompletimin e lendeve per ti dorëzuar tek avokati.

Pregatitja e raportit per shpenzime kontigjente per vitin 2025 të bartura nga viti 2024 ku arrinë vlerën afer **3,303,902.78 €**, në këtë raport nuk janë përfshirë kontestet të cilat nuk ju dihet vlera deri ne marrjen e ekspertizes si dhe kontestet pronesore qe kanë të bëjnë me vërtetim prone.

Poashtu në këtë vitë si zyre ligjore kemi punuar ne hartimin e listes se lendeve gjyqesore te ndara ne llojet e ndryshme te kontesteve duke pefshire me gjeresisht Kontraten Kolektive te Arsimit.

Ky raport ka pershire lendet Gjyqesore të përfunduara dhe njekohesisht te paguara nga DEFZH, dhe poashtu lendet të cilat janë të përfunduara me verdikt gjyqesor por te nejtat nuk jane paguar, si dhe te gjitha lendet te cilat jane te procedure gjyqesore.

Në vitin 2024 sipas kërkesës së DI-s zyra ligjore ne bashkepunim me shefin e inspektoratit ka pregatitur edhe disa lendë në procedure permbarimore bëjnë me mospagesë të të shqiptimit të gjobave.

-Përcjelljen e ligjeve ,Rregulloreve dhe udhëzimeve administrative përmes ueb faqeve të Kuvendit të Republikës Kosovës dhe Qeverisë.

-Pjesmarrje ne takimet e rregullta të kolegjiunit të zyrtarëve ligjor në kuadër të Asociacionit të Komunave të Rrepublicës së Kosovës

-Hartimi i raportit për shpenzime kontigjene për DEFZH dhe auditorin gjeneral

-Këshilla për zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe udhezimeve administrative të cilat vijnë nga niveli qendror, sipas kërkesave të drejtorive .

-Pjesmarrje të rregullta në mbledhjet e komitetit për politikë dhe financa dhe mbledhjet e Kuvendin e Komunes ku në bashkëpunim me sekretarinë e Kuvendit dhe me kryesuesen bëjnë përpilimin e akteve të ndryshme nga fushëveprimtaria e kuvendit komunal

-Takime të rregullta me Avokatin e Komunës ,bashkëpunim dhe koordinim të punës në çështjet gjyqësore, përpilimin e përgjigjeve në padi dhe shkresa tjera, sigurimin e provave nga ana e drejtorive përgjegjëse për secilën lëndë që i përket atyre ,pjesmarrje në seanca gjyqësore dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me të gjitha lëndët gjyqësore ne cilësinë e palës paditëse dhe të paditur.